



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 48 regjistër (JR)
Datë 30.08.2021

Nr. 45 i vendimit
Datë 26.10.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 26.10.2023, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 364, datë 02.04.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Hicka.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet A, Ç, D, Dh, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet me shkrim të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, e cila përfundimisht kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë në tërësi,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Në funksion dhe në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 31, pika 1, nenin 35, pika 1 dhe nenin 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (ii) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe (iii) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGJ”), prej të cilave rezultoi si më poshtë.
3. Pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, me nr. {***} prot., datë 17.04.2018.
4. Me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera. Për këtë qëllim, ka dërguar raportin e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në të cilin ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

5. Për vlerësimin e aftësive profesionale, KLGj-ja pasi ka rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.
6. Në përputhje me nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit, zhvilloi procesin e rivlerësimit kalimtar bazuar në tri kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Bazuar në provat e administruara, si dhe pasi shqyrtoi të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni, me vendimin objekt shqyrtimi nr. 364, datë 02.04.2021, për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Hicka, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka arritur në përfundimin që t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.
7. Në vendimin e tij, Komisioni ka vendosur shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, mbi konkluzionet si më poshtë.

7.1. Për vlerësimin e kriterit të pasurisë: Për pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 120,3 m², ndodhur në Tiranë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë vetting lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në vlerën 82.000 euro, dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, gerrat "a", "b" dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Për pasurinë automjet "Ford Kuga", trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë vetting lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, pasi nuk provoi burimin e ligjshëm të huasë 1.800.000 lekë, përdorur si burim krijimi në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, gerrat "a", "b" dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se, bazuar në konkluzionet e arritura më lart, në konsideratë dhe të standardeve të vendosura nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

7.2. Për kriterin e kontrollit të figurës: Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, bazuar në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, arriti në përfundimin se subjekti ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

7.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale: Trupi gjykues, bazuar në konstatimet e mësipërme, argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", pas një analize në përputhje me ligjin nr. 84/2016, "Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në

Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësisë profesionale.

II. Shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka

8. Pranë Komisionit është administruar ankimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Hicka, datë 26.07.2021, me nr. prot. {***}, kundër vendimit nr. 364, datë 02.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky ankim është paraqitur brenda afatit ligjor, sipas nenit 63¹, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në konkluzion të ankimit të saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, në përmbushje të procesit të rregullt ligjor, kërkoi nga Kolegji të riçelet hetimi gjyqësor dhe:
- (i) të administrohen tabelat financiare bashkëlidhur ankimit, me përmbledhje të analizës financiare sipas pretendimeve të subjektit, detajim i pretendimeve mbi të ardhurat e babait, detajim i prapësimeve për shpenzimet e prindërve të subjektit;
 - (ii) të thirret për t’u pyetur në cilësinë e dëshmitarit/ekspertit hartuesin e dokumentit “Metodikë e analizës financiare” dhe të analizave financiare;
 - (iii) të merren nga ILDKPKI-ja, shortet e hedhura për kontrollin e deklaratës së parë të vitit 2003 e në vijim, si edhe të gjitha raportet, fletëkontrollet apo çdo dokument tjetër që shprehet mbi përfundimet, për kontrollet e DPV-ve të mbajtura nga ky institucion si për kontrollin aritmetik dhe logjik, ashtu dhe për kontrollet e plota;
 - (iv) të merren nga KLGj-ja për vlerësimin e pasurive të kandidatëve të tjerë për KLGj, analizat financiare të tyre, metodologjinë e kryerjes së analizave të tyre;
 - (v) të merren nga Komisioni analizat financiare të të gjitha subjekteve të rivlerësimit, që përmbajnë një analizë mbi të ardhurat që vijnë nga biznesi dhe t’i vendosë ato në dispozicion të subjektit për të verifikuar pretendimet për diskriminim;
 - (vi) t’i vendosen subjektit në dispozicion të të gjitha analizat financiare të kryera nga Kolegji të të gjitha subjekteve të rivlerësimit, që përmbajnë një analizë mbi të ardhurat që vijnë nga biznesi, t’i vendosë ato në dispozicion të subjektit për të verifikuar pretendimet për diskriminim;
 - (vii) të merren në konsideratë në analizën përfundimtare financiare, shumat sipas kërkimeve specifike dhe tabelat në këtë dokument dhe bashkëlidhur tij;
 - (viii) për rastin e të ardhurave nga puna e nënës, meqenëse në Bashkinë Lushnjë nuk ekzistojnë regjistra për të vetëpunësuarit për periudhën e rivlerësimit, të aplikohet neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016;
 - (ix) përfundimisht, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, kërkoi nga Kolegji të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 364, datë 02.04.2021, të Komisionit dhe në zbatim të ligjit nr. 84/2016, të vendosë konfirmimin e saj në detyrë.

¹ “Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit”.

8.1. Shkaqet procedurale të ankimit, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka:

8.1.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është marrë si rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, i cili konsiston në disa elemente, si më poshtë vijojnë.

(i) Analizat financiare apo kërkesat për përlllogaritje të të ardhurave të caktuara nuk janë pasqyruar në vendim dhe nuk i është dhënë përgjigje në Komision në përmbushje të procesit të rregullt ligjor.

(ii) Barra e provës e vendosur për huatë është në tejkalim të parashikimeve ligjore dhe kushtetuese, si dhe vetë praktikën e Kolegjit për vendosjen e barrës së provës dhe janë të paqarta faktet që kërkohen të provohen.

(iii) Mungesa e prezumimit të pafajësisë, si pjesë e elementeve të procesit të rregullt ligjor.

(iv) Trajtim i pabarabartë i subjekteve në Komision, ku konsiston në përdorimin e kriterëve të ndryshme në përlllogaritjen e të ardhurave të ligjshme për personat e tjerë të lidhur.

8.1.2 Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka vijuar një proces administrativ krejtësisht i privuar nga garancitë e sigurisë juridike, në drejtim të kuptueshmërisë së ligjit, pa ditur dhe pa kuptuar përmbajtjen e termave për të cilët i është kërkuar të japë shpjegime, si: “pasuri e ligjshme”, “të ardhura të ligjshme”, si dhe “burimet e krijimit të pasurisë”.

Shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

8.1.3. Për pasurinë “apartament banimi, me sip. 120,3 m²”, ndodhur në kompleksin rezidencial “{***}”, Tiranë, në ankim: (i) subjekti i rivlerësimit pretendon vendosjen e barrës së provës në mënyrë të paqartë, duke qenë se shtrihet përtej kufijve ligjorë dhe kushtetues; (ii) lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, pretendon se pasuria e prindërve të saj është krijuar me punë të ligjshme. Në lidhje me të ardhurat e nënës së subjektit të rivlerësimit, ajo pretendon se janë përfituar nga të ardhura të ligjshme si e vetëpunësuar në tregun e fruta-perimeve në Lushnjë. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Hicka, të ardhurat e prindërve të saj për periudhën 01.01.2004 - 31.12.2010, në shumën 5.032.512 lekë, kanë qenë të mjaftueshme për të mbuluar huanë prej 1.500.000 lekësh dhe për periudhën 01.01.2004 - 31.12.2015, në shumën 8.066.955 lekë, kanë qenë të mjaftueshme për mbulimin e huasë në shumën 5.000.000 lekë; (iii) lidhur me të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e apartamentit të bashkëshortit, subjekti i rivlerësimit pretendon se e ka deklaruar në vitin 2009, edhe pse situata nuk ishte e qartë juridikisht dhe nuk ishte formalizuar veprimi juridik për kalimin e të drejtave të kontratës së sipërmarrjes.

8.1.4. Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë automjet, tip “Ford Kuga”, në shumën 1.800.000 lekë të dhënë hua nga prindërit, subjekti pretendon se kishin të ardhura të mjaftueshme për të dhënë huanë dhe se këto të ardhura janë krijuar me burime financiare të ligjshme.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegji

i. Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Hicka, duke vendosur shkarkimin e saj nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

10. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes

11. Në përputhje me nenin 65, pika 1² e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i çështjes në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi mbi bazë aktesh, gjithashtu edhe në rastet kur nuk jemi në kushtet e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”). Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 364, datë 02.04.2021, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Hicka, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në bazë të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

11.1. Trupi gjykues shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit të paraqitur në ankim, ku kërkoi nga Kolegji që gjykimi i çështjes së saj të zhvillohet në seancë gjyqësore publike, të administrohen si prova të reja aktet që kërkoi të merren³ nga Kolegji, si dhe ato që i ka bashkëngjitur ankimit.

² “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

³ Subjekti kërkoi të administrohen nga Kolegji provat e cituara në paragrafin 8, pikat (ii), (iii), (iv) dhe (v) më sipër.

11.2. Trupi gjykues vëren se në ankimin e paraqitur prej subjektit të rivlerësimit, të protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 26.07.2021, janë bashkëlidhur disa akte shkresore⁴, për të cilat subjekti i rivlerësimit pretendon të merren si prova të reja në kuadër të shqyrtimit të çështjes. Më datë 06.10.2023, në Kolegj janë depozituar parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Hicka, me nr. prot. {***}, në funksion të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi të datës 12.10.2023. Subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar akte shkresore bashkëlidhur parashtrimeve.

11.3. Trupi gjykues vëren se, bazuar në parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, parashikohet se: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.* Gjithashtu, sipas nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, parashikohet: *Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] marrja e provës duket se është e panevojshme.* Trupi gjykues, pasi vlerësoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të lejuar marrjen e akteve si prova të reja, si dhe pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit për gjykimin e kësaj çështjeje në seancë gjyqësore publike, vendosi që këto akte shkresore të mos merren në cilësinë e provës, bazuar në nenet 47 dhe 49, paragrafi i dytë i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, dhe nenin 49, pika 6, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, duke arsyetuar si vijon.

11.4 Në zbatim të parashikimeve ligjore, lidhur me këtë çështje, trupi gjykues vlerësoi se për aktet e paraqitura prej subjektit të rivlerësimit bashkëlidhur ankimit, nuk provohet se pamundësia e paraqitjes së tyre që në fazën e hetimit administrativ në Komision, ka qenë pa fajin e saj, siç kërkon neni 47 i ligjit nr. 49/2012. Në vlerësim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të gjitha pretendimeve të parashtruara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk evidentoi shkelje procedurale në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegj, me praninë e subjektit të rivlerësimit, për korrigjimin e tyre.

11.5 Trupi gjykues, në konkluzion të arsyetimit të mësipërm, vlerësoi që çështja të gjykohej në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazën e akteve të administruara në Komision, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka

i. Analizimi i shkaqeve procedurale të ankimit

- 12.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është marrë si rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, i cili konsiston në disa elemente. (i) Subjekti i rivlerësimit shpjegon se asnjë nga

⁴ Tabelë e analizës financiare përmbledhëse; tabelë e shpenzimeve të prindërve të subjektit të rivlerësimit; tabelë e të ardhurave të babait të subjektit të rivlerësimit; e-mail komunikimi me Komisionin, njoftim për seancë.

pretendimet dhe analizat e saj financiare, apo kërkesat për përlllogaritje të të ardhurave të caktuara, nuk janë pasqyruar në vendim dhe as i është dhënë përgjigje në Komision, në përmbushje të procesit të rregullt ligjor. (ii) Barra e provës e vendosur për huatë është në tejkalim të parashikimeve ligjore dhe kushtetuese, si dhe vetë praktikën e Kolegjit për vendosjen e barrës së provës, dhe janë të paqarta faktet që kërkohen të provohen. (iii) Subjekti pretendoi se mungesa e prezumimit të pafajësisë ka cenuar procesin e rregullt ligjor. (iv) Subjekti ka pretenduar se ka pasur trajtim të pabarabartë me subjektet e tjera në Komision, që konsiston në përdorimin e kriterëve të ndryshme në përlllogaritjen e të ardhurave të ligjshme për personat e tjerë të lidhur.

12.1 Lidhur me pretendimin për mospasqyrimin në vendim të disa të ardhurave, për të cilat subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, ka kërkuar të përlllogariten në analizën e saj financiare, nga verifikimi i procedurave të zhvilluara në Komision, trupi gjykues vëren se subjektit të rivlerësimit i janë analizuar pretendimet e saj nga Komisioni lidhur me përfshirjen e disa të ardhurave si të ligjshme në analizën e saj financiare, por mungon një analizë e hollësishme ligjore e Komisionit për këto të ardhura, që kanë sjellë si rezultat rëndimin e pozitës së subjektit deri në shkarkimin e saj nga detyra për diferencat negative të përlllogaritura nga Komisioni. Me të drejtë, subjekti ka pretenduar që të ardhurat nga qiratë, si dhe të ardhurat e prindërve të subjektit që kanë shërbyer për dhënien e huasë për blerjen e apartamentit, duhet të ishin konsideruar të ardhura të ligjshme. Trupi gjykues e gjen të bazuar pretendimin e subjektit që këto të ardhura të konsiderohen të ligjshme dhe të jenë të përfshira në analizën financiare, duke i trajtuar më poshtë, në kuadër të vlerësimit të pasurisë, si dhe në kuadër të respektimit të të drejtave të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Hicka, për një proces të rregullt dhe ligjor, siç ajo ka pretenduar në ankimin e paraqitur. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për mospërmbushje të procesit të rregullt, për shkak të mungesës së përgjigjeve të dhëna nga Komisioni, nga verifikimi i trupit gjykues rezultoi se në Komision i është garantuar e drejta e njohjes me aktet e administruara gjatë hetimit paraprak, që çështja e saj të dëgjohet publikisht, si dhe brenda një afati të arsyeshëm. Vendimi i është komunikuar publikisht, duke i dhënë më parë të drejtën për të paraqitur qëndrime, shpjegime dhe prova për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore, si dhe të depozitohet prova. Subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar disa herë shtyrjen e afatit për të paraqitur prapësimet mbi rezultatet e hetimit, kërkesa të cilat janë pranuar nga Komisioni, duke i dhënë kohë të mjaftueshme për t'i paraqitur parashtrimet dhe kundërshtuar barrën e provës. Gjithashtu Komisioni, në vlerësim të respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe për të mos lejuar që subjekti të vendosej në një gjendje të pafavorshme për shkak të mosmarrjes së informacionit apo mosdijënisë mbi fakte që nevojiten për mbrojtjen e saj efektive, nëpërmjet ushtrimit të kompetencave, *ex officio*, si dhe për të parandaluar çdo disavantazh, ka dhënë shpjegime shtesë lidhur me barrën e provës për huamarrjet nga prindërit e saj në vitet përkatëse, 2010 dhe 2015. Komisioni me të drejtë i ka administruar provat dhe i ka analizuar ato, pavarësisht se si ka konkluduar për vlerën e tyre provuese.

12.2 Lidhur me mungesën e prezumimit të pafajësisë, si pjesë e elementeve të procesit të rregullt ligjor, të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me çështjen e barrës së provës, vlerësohet se, referuar parashikimit të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, përcaktohet se barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti

procesin penal. Me kalimin e barrës së provës subjektit të rivlerësimit, lidhur me gjetjet e rezultuara nga procesi i hetimit administrativ, Komisioni nuk ka cenuar të drejtën e subjektit për t'u mbrojtur, por ka zbatuar procedurën e rivlerësimit kalimtar, sipas parashikimit kushtetues dhe atij ligjor.

12.3 Pretendimi për tejkalim të barrës së provës së kaluar nga Komisioni subjektit të rivlerësimit për huatë e prindërve, gjen trajtim në analizimin e shkakut të ankimit lidhur me mundësinë e dhënies së huasë nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, në vijim të këtij vendimi. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, ka pretenduar në ankim se barra e provës së kaluar nga Komisioni për të provuar mundësinë e prindërve të saj për të dhënë hua shumë që ka shërbyer për likuidimin e apartamentit, është në tejkalim të parashikimeve ligjore dhe kushtetuese, si dhe vetë praktikën e Kolegjit për vendosjen e barrës së provës dhe janë të paqarta faktet që kërkoheshin të provohen me kalimin e barrës së provës. Prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë investuar në bono thesari nga viti 2003, në shumën 2.700.000 lekë, investim i cili ka gjeneruar të ardhura nëpërmjet interesave bankarë, dhe është riinvestuar deri në vitin 2015 që i është dhënë huaja subjektit, fakt që konfirmon se ky investim ishte i prindërve, duke shmangur çdo dyshim se paratë derivojnë nga të ardhura të paligjshme nga funksioni i subjektit si gjyqtare. Si rrjedhojë, nga kontrolli që Kolegji i bëri analizës financiare të Komisionit, u verifikuan investimet në llogaritë bankare të prindërve për periudhën 2010-2015, duke verifikuar në këtë periudhë mundësinë e tyre për burime financiare të ligjshme, bazuar në rezultatin e gjeneruar nga zbritja e shpenzimeve (shpenzimet jetike dhe huanë) nga të ardhurat.

12.4 Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka cenuar parimin e barazisë para ligjit të subjekteve të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Një qëndrim i tillë i Kolegjit është tashmë i konsoliduar me vendimmarrje⁵ të mëparshme të tij.

ii. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me kriterin e pasurisë dhe shkaqet e ankimit për këtë kriter

- 13.** *Për pasurinë “apartament banimi me sip. 120,3 m²”, ndodhur në kompleksin rezidencial “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit kundërshton në ankim vendosjen e barrës së provës nga Komisioni, si e paqartë dhe që shtrihet përtej kufijve ligjorë dhe kushtetues. Subjekti në ankim pretendon se ka pasur paqartësi në barrën e provës që i është kaluar për burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve që kanë shërbyer për dhënien e huave, si dhe paligjshmërinë dhe antikushtetutshmërinë e procedurës për vendosjen e barrës së provës. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, pretendon se pasuria e prindërve të saj është krijuar me punë të ligjshme. Në lidhje me të ardhurat e nënës së subjektit të rivlerësimit, ajo pretendon se janë krijuar nga të ardhura të ligjshme si e vetëpunësuar në tregun e fruta-perimeve në Lushnjë dhe shpjegon se kjo është e besueshme për arsyet se nëna e saj nuk rezulton e punësuar në ndonjë*

⁵ *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit: nr. 11/2021 (JR), datë 31.03.2021; nr. 8/2022 (JR), datë 07.04.2022.*

veprimtari tjetër. Subjekti pretendon se i ka deklaruar këto të ardhura nëpërmjet deklaratave periodike të pasurisë, gjithashtu ka paraqitur deklaratën noteriale të nënës dhe babait të saj, si dhe një deklaratë të individit E. G.. Ajo pretendon se nëna e saj ka likuiduar të gjitha detyrimet tatimore në kohët të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme kundrejt Bashkisë Lushnjë, sipas legjislacionit rregullues të kohës. Sipas subjektit të rivlerësimit, të ardhurat e prindërve të saj për periudhën 01.01.2004 - 31.12.2010, në shumën 5.032.512 lekë, kanë qenë të mjaftueshme për të mbuluar huanë prej 1.500.000 lekësh dhe të ardhurat për periudhën 01.01.2004 - 31.12.2015, në shumën 8.066.955 lekë, kanë qenë të mjaftueshme për mbulimin e huasë në shumën 5.000.000 lekë. Subjekti pretendon se hetimi i Komisionit duhet të konsideronte të mjaftueshme të ardhurat më sipër dhe çdo interpretim tjetër i barrës së provës në lidhje me këtë çështje, do të ishte i kundërligjshëm.

Lidhur me të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e apartamentit të bashkëshortit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se e ka deklaruar këtë të ardhur që nga viti 2009, edhe pse situata nuk ishte e qartë juridikisht dhe nuk ishte formalizuar veprimi juridik për kalimin e të drejtave të kontratës së sipërmarrjes. Subjekti shpjegon se ka deklaruar të drejtat mbi këtë apartament, duke qenë se në vitin 2009 është dhënë me qira dhe duhet të deklaronte të ardhurat që merrte nga kjo pasuri. Sipas subjektit, pagesat e qirasë i kanë kaluar në rrugë bankare dhe gjithçka që mund të bënte ishte të shpjegonte raportin që kishte personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, me këtë apartament në Deklaratën e Interesave Privatë Periodikë (në vijim "DIPP") të kohës, duke menduar se e kishte deklaruar saktësisht.

13.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting, për apartament banimi me sipërfaqe 120,3 m², duke mos deklaruar huanë e marrë nga prindërit e saj, në vlerën 5.000.000 lekë, në vitin 2015, si burim krijimi, e vendos subjektin në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa "a" dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar dokumentacion justifikues ligjor lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë së dhënë hua nga prindërit, në vlerën 5.000.000 lekë, si dhe ligjshmërinë e të ardhurave nga qiratë, Komisioni arrin në konkluzionin se nuk duhen konsideruar këto të ardhura në analizën financiare për vlerësimin e mundësisë së krijimit të kësaj pasurie, dhe kjo passjell mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke mos arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me pamundësinë financiare për krijimin e saj. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 120,3 m², në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa "b" dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*

13.2 Nga aktet e administruara në dosje, ka rezultuar se në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kontratë prenotimi për apartament 120,3 m², si burim krijimi ka deklaruar kursime nga paga, të ardhura të tjera të deklaruara këtu, të ardhura nga qiratë dhe*

kredi bankare, i paregjistruar. Vlera e apartamentit është deklaruar 90.000 euro, pjesa takuese 100%.

Gjithashtu në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kontratë porosie për apartament, vlera 90.000 euro, pjesa takuese 100%. Në seksionin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë apo fizikë, pjesë e kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar: Huamarrje për blerje apartamenti, 5.000.000 lekë. Detyrim për pagim çmimi për kontratë sipërmarrjeje, për ndërtim apartamenti, shuma e shlyer deri në 31 dhjetor të vitit 2015, të deklarimit, është 63.000 euro, gjendja e detyrimit të mbetur 27.000 euro. Në seksionin të dhënave konfidenciale në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: Huamarrje babait të deklarueses, shtetasit H. B., e deklaruar në këtë deklaratë për blerje apartamenti.*

Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit, në seksionin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë apo fizikë, ka deklaruar: *Detyrim për pagim të çmimit të kontratës së sipërmarrjes, deklaruar në DIPP-në e vitit 2015, shuma e paguar 23.000 euro dhe detyrim të mbetur pa paguar deri në datën 31.12.2016, në vlerën 4.000 euro.*

13.3 Trupi gjykues vëren se me kontratën e sipërmarrjes për prenotim apartamenti, datë 14.05.2015, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj në cilësinë e porositësve, kanë porositur te shoqëria “{***}” ShPK, apartamentin e ndodhur në kompleksin rezidencial “{***}”, në rrugën “{***}”, Tiranë, me sipërfaqe 120,3 m², kundrejt çmimit prej 90.000 eurosh. Në pikën 5.3 të kësaj kontrate, është parashikuar pagesa e çmimit si vijon: (i) shuma 3.000 euro do të paguhej deri në datën 15.05.2015; (ii) shuma 24.000 euro do të paguhej deri në datën 30.05.2015; (iii) shuma 36.000 euro do të paguhej deri në datën 30.11.2015, me përfundimin e punimeve të muraturës së apartamentit; (iv) shuma 23.000 euro do të paguhej deri më datë 30.04.2016, me dorëzimin e çelësave të apartamentit; (v) shuma 4.000 euro do të paguhej me regjistrimin e kësaj pasurie.

13.4 Lidhur me burimet që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, rezultoi se në deklaratën *vetting*, si burim për blerjen e këtij apartamenti, janë deklaruar: (i) kursime nga paga; (ii) të ardhura nga qiratë; dhe (iii) kredi bankare. Në deklarin periodik vjetor për vitin 2015 (paragrafi 13.2 më sipër), është deklaruar *huamarrje në vlerën 5.000.000 lekë për blerje apartamenti, dhe është përcaktuar se huaja është marrë nga z. H. B., babai i subjektit.* Nga këto deklarime, rezulton që subjekti në deklaratën *vetting*, nuk ka deklaruar huanë e marrë nga prindërit, në vlerën 5.000.000 lekë, që ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2015.

Kredia bankare e deklaruar si burim në deklaratën *vetting*, dhënë më datë 23.12.2016, nga banka “Societe Generale Albania”, në shumën 3.000.000 lekë, është disbursuar më vonë se koha e kryerjes së pagesave për apartamentin të cilat rezulton të kenë përfunduar në datën 27.05.2016, për rrjedhojë, Komisioni nuk ka konsideruar që kredia ka shërbyer për likuidimin e çmimit të kësaj pasurie. Për të analizuar burimet e krijimit të pasurisë dhe mundësinë e subjektit për pagimin e çmimit të apartamentit, Komisioni u është referuar deklaratimeve periodike vjetore të subjektit, si dhe deklaratës së pasurisë *vetting*.

13.5 Lidhur me huanë e dhënë nga prindërit në shumën 5.000.000 lekë, Komisioni administroi aktmarrëveshjen⁶, datë 13.11.2015, të lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit në cilësinë e huamarrësit dhe personave të tjerë të lidhur, prindërve të subjektit në cilësinë e huadhënësve, sipas së cilës palët kanë përcaktuar se: *Kjo aktmarrëveshje rregullon të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të palëve në lidhje me detyrimin monetar 4.260.000 lekë (datë 01.12.2015 dhe 02.12.2015) që huadhënësit i kanë dhënë huamarrësit për efekt të pagimit të një pjese të çmimit të kontratës nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 14.05.2015, që huamarrësit kanë lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK, për blerjen e një apartamenti banimi, huamarrësit marrin përsipër të kthejnë shumën e marrë hua brenda një afati 5-vjeçar, duke nisur nga dita e lidhjes së kësaj aktmarrëveshjeje.*

13.6 Trupi gjykues vëren se nga llogaria e nënës së subjektit, znj. N. B., pranë Bankës së Shqipërisë⁷ janë maturuar më datë 12.11.2015, bonot e thesarit, në shumën 2.993.128 lekë. Kjo shumë më pas është kredituar në llogarinë e saj personale [të nënës] në ABI Bank, prej së cilës në datën 01.12.2015, është transferuar pagesa në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, në vlerën 3.001.500 lekë, me përshkrim: “Pagesë për llogari të Alma Hicka, për shlyerje të këstit të dytë të kontratës nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 14.05.2015, me “{***}” ShPK”. Gjithashtu rezultoi se nga llogaria e nënës së subjektit në datën 01.12.2015, pasi është maturuar depozita me afat, është kryer pagesa tjetër në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, në shumën prej 1.260.000 lekësh, me përshkrimin: “Pagesë këst apartamenti sipas kontratës nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 14.05.2015, për llogari të Alma Hicka”. Nga aktet në dosje, rezulton se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë kaluar nga maturimi i depozitave të tyre bankare gjithsej shumën prej 4.261.500 lekësh në llogarinë bankare të shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK, për të kryer pagesën e apartamentit të blerë nga vajza e tyre, subjekt rivlerësimi, Alma Hicka. Pjesa tjetër e mbetur nga huaja prej 5.000.000 lekësh, siç ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 1 të Komisionit, i është dhënë nga prindërit në *cash* subjektit të rivlerësimit, për të mbuluar shpenzimet që u krijuan nga blerja e apartamentit. Komisioni, në zbatim të kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i kërkoi subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Hicka, të justifikojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të likuiditeteve të dhëna hua nga prindërit e saj, duke i kërkuar të paraqesë edhe dokumentacion justifikues për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huasë, si dhe arsyet e mosdeklarimit të saj në deklaratën *vetting* si burim krijimi të kësaj pasurie.

13.7 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit lidhur me barrën e provës së kaluar nga Komisioni për ligjshmërinë e krijimit të shumës së dhënë hua nga prindërit, ka sqaruar se: *Në lidhje me deklarimin e burimit të krijimit të pasurive në deklaratën vetting, në rastin kur huatë kanë qenë të shlyera, kam arsyetuar se ato janë paguar në mënyrë përfundimtare me të ardhurat dhe kursimet familjare, ndërsa në rastin kur huaja nuk është shlyer plotësisht, kam deklaruar huanë në vijim, si burim i krijimit të pasurisë. Në logjikën time, burimi i krijimit të një*

⁶ Marrëveshje ndërmjet palëve, dërguar nga OTP Bank, në përgjigjen nr. {***} prot., datë 21.05.2020.

⁷ Shkresa kthim-përgjigje nr. {***} prot., datë 18.05.2020, e Bankës së Shqipërisë; shkresë kthim-përgjigje nr. {***} prot., datë 18.05.2020, nga ABI Bank.

*pasurie, pasi është shlyer huaja që fillimisht është marrë për të, nuk është më huaja, por të ardhurat që kanë kontribuar për të shlyer huanë. Lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të huasë së dhënë nga prindërit, subjekti ka shpjeguar se: Të ardhurat e prindërve të mi për krijimin e shumave që më kanë dhënë hua, janë krijuar nga puna e babait tim në shoqërinë “{***}” ShPK, Lushnjë, deri në vitin 2013, puna e tij në Ujësjellës-Kanalizime Tiranë, deri në vitin 2018, aktiviteti privat i shitjes së mamasë sime në Lushnjë (siç e kam deklaruar në deklaratat e vitit 2003 dhe 2004), deri në vitin 2013. Pasuria e prindërve të mi ka qenë në depozita bankare përpara marrjes së huasë dhe gjendet aktualisht edhe sot, që tregojnë se ata kanë disponuar në të gjitha momentet që më kanë dhënë hua, pasuri të mjaftueshme në likuiditete bankare [...].*

13.8 Lidhur me të ardhurat e babait të subjektit të rivlerësimit, z. H. B., nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se me shkresën me nr. {***} prot., datë 18.05.2020, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka konfirmuar se të ardhurat nga punësimi për periudhën korrik 2005 - janar 2013, kanë qenë afërsisht në shumën 3.525.336 lekë, ndërsa për periudhën janar 2013 deri në kohën e dhënies së huasë së deklaruar në dhjetor të vitit 2015, babai i subjektit të rivlerësimit nuk figuron i punësuar dhe punësimi i tij pranë Ujësjellës-Kanalizime ka filluar në prill të vitit 2016, pagesa të cilat nuk kanë ndikuar në të ardhurat që kanë shërbyer deri në kohën e dhënies së huasë.

13.9 Trupi gjykues vëren se nga verifikimi i dokumentacionit bankar, konfirmohen kreditime në llogarinë e babait të subjektit nga data 21.07.2005. Nga vërtetimi⁸ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të dorëzuar nga subjekti në Komision, rezulton se babai i subjektit është paguar me pagesë papunësie për periudhën shkurt 2013 - janar 2014, në vlerën totale 82.200 lekë. Gjithashtu, nga shkresa e ISSh-së, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit ka qenë i punësuar në shoqërinë “{***}” ShPK që nga viti 1995. Në këto vërtetime është përcaktuar paga mbi të cilën është derdhur kontributi për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Në deklaratën e parë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, të vitit 2003, babai i subjektit, si person i lidhur, ka deklaruar bono thesari në vlerën 2.700.000 lekë, të krijuara me të ardhurat nga kursimet.

13.10 Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 11.09.2020, i ka kërkuar informacion shoqërisë në falimentim “{***}” ShPK, për punësimin dhe pagat e përfituara nga z. H. B. nga viti 1994 e në vijim. Me shkresën kthim përgjigjeje, të datës 23.10.2020, administratorja e falimentit ka konfirmuar se nga viti 1994 – 31.01.2013, listëpagesat e punonjësve dorëzoheshin pranë drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore. Lidhur me pagesat e kryera, nuk disponohet dokumentacioni i kërkuar, duke konfirmuar se z. H. B., gjatë procesit të falimentimit të shoqërisë “{***}” ShPK, ka përfituar dëmshpërblim në shumën prej 519.552 lekësh, e përfituar nga shpërndarja e masës së falimentimit sipas vendimit nr. {***}, datë 25.07.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor (seksioni i falimentit) Tiranë.

13.11 Subjekti i rivlerësimit parashtroi në ankim se të ardhurat e babait të saj janë llogaritur në mënyrë të gabuar, pasi në përlllogaritje nuk duhet të konsiderohej vetëm paga bazë, por duhet të konsideroheshin si të ardhura, sipas Kodit të Punës dhe kontratës kolektive, edhe pjesëmarrja në

⁸ Vërtetimi nr. {***} prot., datë 25.09.2020.

fitim dhe pagesa për ushqim. Në dokumentacionin e administruar në dosje, nuk gjenden të dhëna nëse në llogarinë e babait janë kredituar edhe shumat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit apo ndonjë dokumentacion, i cili të provojë se këto pagesa janë tërhequr dorazi nga babai i subjektit dhe, për këtë arsye, në përlllogaritjen e pagës së tij u konsideruan vetëm të ardhurat për të cilat është paraqitur dokumentacion provues për përfitimin e tyre.

13.12 Në përfundim, lidhur me të ardhurat e përfituara nga babai i subjektit të rivlerësimit, nga kontrolli që Njësia e Shërbimit Ligjor të Kolegjit ushtroi në analizën financiare të kryer nga Komisioni, u konsideruan të ardhurat neto, për rastet të cilat ato ishin të verifikueshme, duke qenë se këto janë të ardhurat e disponueshme të familjes së babait të subjektit të rivlerësimit për të analizuar mundësinë e dhënies së huasë. Trupit gjykues i rezultoi se të ardhurat e dokumentuara nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. H. B., nga paga, rezultojnë në vlerën 4.187.252 lekë për periudhën 2004-2015. Si rrjedhojë, duke vlerësuar edhe faktin se dëmshpërblimi i përfituar sipas vendimit nr. {***}, datë 25.07.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i përket një periudhë kohore pas dhënies së huave subjektit të rivlerësimit, kjo vlerë nuk përfshihet në kohështirjen e analizës financiare të prindërve të subjektit, në cilësinë e personave të tjerë të lidhur.

13.13 *Lidhur me të ardhurat e nënës së subjektit, znj. N. B., rezulton se në deklaratën e parë të pasurisë së vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga vetëpunësimi i nënës në tregun e fruta-perimeve në Lushnjë, si shitëse ambulante, në shumën 50.000 lekë në muaj, ndërsa në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar për nënën e saj, të ardhura nga puna në tregun e fruta-perimeve në Lushnjë, në shumën 800.000 lekë në vit. Duke u nisur nga këto deklarime, Komisioni ka kërkuar informacion në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Fier (në vijim “DRT”), për personin tjetër të lidhur N. B.. DRT Fier, me shkresën⁹ e datës 21.09.2020, ka konfirmuar se nëna e subjektit nuk rezulton e regjistruar si përfaqësuese e ndonjë subjekti tatimor, apo si kontribuuese e sigurimeve shoqërore e shëndetësore pranë kësaj drejtorie deri më datë 18.09.2020. Lidhur me këto të ardhura, e pyetur nga Komisioni në pyetësin nr. 2, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur se: *Specifikisht, në vitet 2003 dhe 2004, mamaja ime ka deklaruar të ardhura nga vetëpunësimi në tregun fruta-perime Lushnjë, si shitëse, në vitin 2003, vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj dhe në vitin 2004 ka përfituar të ardhura totale prej 800.000 (tetëqind mijë) lekësh. Në këtë punë mamaja ime ka punuar fillimisht së bashku me një shoqe pune e më pas ndihmohej nga babai. Punësimi ishte arsyeja përse prindërit e mi jetonin në Lushnjë, ndërsa unë me motrat që ndiqnim shkollën, banonim në Tiranë. Për këtë punë, mamaja ime, kujtoj që ka paguar një tarifë ditore që merrej nga Bashkia Lushnjë, por nuk ka paguar sigurime shoqërore e shëndetësore dhe prandaj gëzon sot pensionin minimal në shkallë vendi.**

13.14 Komisioni, pasi administroi dokumentacionin e dërguar nga subjekti i rivlerësimit me pyetësorët, si dhe deklaratimet e subjektit në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike vjetore, kreu përlllogaritjet sipas të cilave të ardhurat e prindërve të subjektit të dokumentuara, mbi të cilat ishin paguar detyrimet tatimore, janë më të vogla se shuma e dhënë hua, prej 5.000.000 lekësh, pa

⁹ Shkresa e DRT Fier, me nr. {***}, datë 21.09.2020.

marrë në konsideratë shpenzimet jetike të huadhënësve, apo shpenzime të tjera gjatë kësaj periudhe kohore. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke konstatuar se: *i) ka mospërputhje midis deklaratës vetting dhe deklarimit periodik në lidhje me burimet e krijimit të kësaj pasurie, pasi subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën vetting huanë e marrë nga prindërit si burim për këtë pasuri; ii) mosprovim me dokumentacion ligjor përkatës, të burimit të ligjshëm të të ardhurave të prindërve që kanë shërbyer për dhënien e huasë subjektit të rivlerësimit, në vlerën prej 5.000.000 lekësh në vitin 2015.*

13.15 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *Barra e provës e vendosur për huatë, është në tejkalim të parashikimeve ligjore dhe kushtetuese për vendosjen e barrës së provës dhe janë të paqarta faktet që kërkohet të provohen. [...] Do isha shumë e gatshme të angazhohesha në procesin e të provuarit dhe do ta bëj me aq sa mundem, por nuk jam në gjendje të kuptoj ende se cilat janë faktet që duhet të provoj, pse deklarimi nuk është i saktë dhe pse deklarimet dhe provat e deritanishme nuk janë të mjaftueshme. Barazia e armëve dhe kontradiktoriteti kërkojnë që ju të sqaroni konkluzionet tuaja, me qëllim që unë, si pala tjetër në këtë procedurë, të mundem t'i kundërshtoj ato. Nëse konkluzionet tuaja nuk janë të qarta dhe s'kanë një arsytim ligjor mbështetës, mua nuk më mbetet gjë tjetër, përveçse të theksoj këtë veprim të kundërligjshëm nga ana juaj, si edhe të ritheksoj se deklarimi është plotësisht në përputhje me ligjin. [...] Duke konsideruar sa më sipër, nuk jam e qartë se për cilat fakte më është ngarkuar barra e provës. Megjithëse në lidhje me këtë kam këmbyer disa e-mail-e me Komisionin dhe përkatësisht trupin gjykues të ngarkuar me procesin tim të rivlerësimit, por përsëri nuk kam marrë deri më sot asnjë sqarim.*

13.16 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Hicka, në përgjigje të barrës së provës, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore të datës 10.03.2021, duke vlerësuar respektimin e parimit të barazisë së armëve dhe për të mos lejuar që subjekti të vendosej në një gjendje të pafavorshme për shkak të mungesës për të marrë informacion apo mësuar mbi fakte që nevojiten për mbrojtjen e saj efektive, nëpërmjet ushtrimit të kompetencave, *ex officio*, si dhe për të parandaluar çdo disavantazh, ka vlerësuar t'i japë subjektit të rivlerësimit shpjegimet shtesë lidhur me barrën e provës për huamarrjen nga prindërit në vitin 2015, duke shpjeguar se:

13.16.1 Në vlerësim të faktit se subjekti i rivlerësimit edhe personat e tjerë të lidhur të deklaruar në cilësinë e huadhënësit, kanë konfirmuar këtë marrëdhënie, referuar pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, ata kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre pasurive, likuiditetet e dhëna hua.

13.16.2 Detyrimi ligjor dhe kushtetues gjatë procesit të rivlerësimit është justifikimi dhe argumentimi me dokumente shoqëruese i ligjshmërisë së burimit të krijimit të kësaj pasurie, likuiditetet dhënë hua nga prindërit dhe përdorur nga subjekti i rivlerësimit, si pjesë e çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 120,3 m², në Tiranë.

13.16.3 Duke qenë se në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2015 (në rubrikën e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë apo fizikë), subjekti i rivlerësimi ka deklaruar – detyrim huamarrjeje, në shumën 5.000.000 lekë, për blerje apartamenti, pra, qëllimi i kësaj huaje ka qenë për blerjen e këtij apartamenti, atëherë në kuptim të parashikimeve të legjislacionit në fuqi, kjo hua ka shërbyer si burim i krijimit të kësaj pasurie.

13.16.4 Lidhur me të ardhurat e babait të subjektit, Komisioni sqaroi subjektin se të ardhurat e dokumentuara nga paga e z. H. B., rezultojnë në vlerën 3.587.919 lekë deri në janar të vitit 2013, duke vlerësuar edhe faktin se dëmshpërblimi i përfituar sipas vendimit të gjykatës nr. {***}, datë 25.07.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i përket një periudhe kohore pas dhënies së huave subjektit të rivlerësimit.

13.16.5 Lidhur me të ardhurat e nënës së subjektit, Komisioni sqaroi subjektin se legjislacioni ka pasur parashikim për regjistrim dhe pagesë tatimi/taksë edhe për ambulancat, përfshirë edhe ata që ushtrojnë aktivitetin në tregjet e miratuara nga bashkitë.

13.16.6 Gjithashtu, Komisioni i evidentoi subjektin të rivlerësimit, znj. Alma Hicka, se nga ana e saj nuk ishte dokumentuar gjendja e pamundësisë lidhur me të ardhurat e përfituara nga nëna, sipas përcaktimeve të parashikuara nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

13.17 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të sqarimeve të mësipërme të Komisionit, lidhur me barrën e provës, ka depozituar në Komision prapësimet me datë 26.03.2021, në të cilat ka sqaruar se ligjshmëria e të ardhurave e pagesa e detyrimeve tatimore janë dy koncepte të ndryshme për ligjin në tërësi, për ligjin nr. 84/2016 dhe ligjet e taksa/tatimeve në veçanti. Qartazi në njërin anë janë të ardhurat dhe në anën tjetër shpenzimet (pagesë të detyrimeve tatimore). Këto dy koncepte nuk ka se si të barazohen apo nënkuptojnë njëra-tjetrën. Së dyti, subjekti ka sqaruar se pagesa e detyrimeve tatimore është detyrim për subjektin e rivlerësimit, personin e lidhur dhe jo për personat e tjerë të lidhur (siç janë personat që gëzojnë cilësinë e huadhënësit). Së treti, detyrimet tatimore qartazi paguhen edhe mbi të ardhura e paligjshme, prandaj ligjshmëria e të ardhurave dhe pagesa e detyrimeve tatimore janë dy koncepte të ndryshme, të përcaktuara në mënyrë të pavarur edhe nga ligji nr. 84/2016 dhe gjithë legjislacioni tjetër në të cilin ky ligj referon.

13.18 Trupi gjykues vëren se neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, përcakton në mënyrë specifike se cilat marrëdhënie përfshihen në fushën e interesit pasuror, ku përfshihet dhe marrëdhënia e huamarrjes prej subjektit të rivlerësimit nga prindërit e saj. Duke qenë se prindërit e subjektit dhe vetë subjekti e konfirmojnë këtë marrëdhënie huaje, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, nën dritën e këtij neni.

13.19 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e paraqitura përpara Komisionit lidhur me barrën e provës, ka paraqitur në Komision shkresën¹⁰ e DRT Fier, sipas së cilës sqarohet se përgjigjja zyrtare bazohet në të dhënat që disponon DRT Fier nga verifikimet e kryera në sistemin tatimor,

¹⁰ Shkresë e DRT Fier nr. {***}, datë 29.01.2021.

si dhe në dosjet që gjenden në arkivin e kësaj drejtorie. Në bazën e të dhënave tatimore, rezultojnë të regjistruar 1367 ambulantë, nga të cilët aktivë janë 357 subjekte. Në shkresë sqarohet se nuk janë evidentuar të ndarë tregtarët ambulantë, me aktivitete fruta-perime. Gjithashtu subjekti ka paraqitur shkresën¹¹ e Bashkisë Lushnjë, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, sipas së cilës sqarohet se në kërkesën e bërë kësaj drejtorie nga subjekti i rivlerësimit, nuk ka asnjë dokumentacion ose të dhënë referuese të tillë, si: kontratë qiraje, certifikatë regjistrimi apo NIPT, çka e bën të pamundur identifikimin e tatimpagueseve para vitit 2012, pasi nuk ka pasur një sistem të mirëfilltë për mbajtjen e të dhënave për tatimpaguesit, të dhëna të cilat janë mbajtur në formatin *excel*, si dhe nga viti 2019, ka filluar sistemi *online*, ku është kryer regjistrimi i të dhënave i të gjithë tatimpaguesve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Bashkisë Lushnjë.

13.20 Në dosjen e Komisionit gjendet e administruar deklarata noteriale me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 09.01.2021, ku deklaruesi E. G. deklaron se nëna e tij, znj. D. Q., prej shumë vitesh ka qenë shoqe me nënën e subjektit të rivlerësimit për shkak se punonin bashkë në tregun e fruta-perimeve pranë stadiumit të Lushnjës. Deklaruesi shpjegon se në kohën kur nëna e subjektit u largua nga Lushnja për të jetuar në Tiranë, ka marrë vendin e saj në treg dhe punon bashkë me nënën e tij. Deklaruesi sqaron se kanë paguar gjithmonë çdo taksë që i ka kërkuar Bashkia Lushnjë, pasi tregu është i bashkisë. Bashkëngjitur deklaratës noteriale gjenden edhe pagesat e taksave të deklaruesit për vitet 2019 dhe 2020. Gjithashtu gjendet e administruar në dosje përgjigjja¹² e drejtuar subjektit të rivlerësimit nga Drejtoria e Arkivave Shtetërore Vendore, sipas së cilës në emër të znj. N. B., nga kërkimet në dokumentet që disponojnë, nuk rezultojnë të dhënat e kërkuara.

13.21 Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në ankim se ligji nr. 84/2016 përcakton si të ardhura të ligjshme ato që krijohen sipas nenit 4 në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”. Burimet e të ardhurave parashikohen në atë ligj për të përcaktuar të ardhurat e tatueshme, sepse në Shqipëri ka edhe të ardhura të tjera të cilat janë të patatueshme. Nga ana tjetër, neni 6¹³ i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, përcakton parimin që taten edhe të ardhurat dhe pasuritë e paligjshme. Qartazi, në kuptimin e së drejtës financiare, një e ardhur nuk është e ligjshme apo e paligjshme për shkak të pagesës së taksave dhe tatimeve dhe as nuk mund të bëhet e ligjshme një e ardhur apo pasuri sepse janë paguar detyrimet tatimore për të.

13.22 Trupi gjykues vëren se lidhur me faktin e të provuarit të ligjshmërisë së të ardhurave të nënës së subjektit të rivlerësimit, rezultoi se institucionet, shkresat e të cilave janë administruar nga Komisioni, nuk disponojnë informacion lidhur me taksat e paguara apo të ardhurat e krijuara nga shitja në tregun e fruta-perimeve në Lushnjë. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, sa i

¹¹ Shkresë e Bashkisë Lushnjë nr. {***}, datë 13.01.2021.

¹² Shkresë e Drejtorisë së Arkivave Shtetërore Vendorë nr. {***}, datë 10.02.2021.

¹³ Neni 6, Detyrimi tatimor: “1. Detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit tatimor.

2. Detyrimi tatimor lind edhe kur personi realizon të ardhura, kryen pagesa, në formë të jashtëligjshme, apo bëhet zotërues i një sendi, në formë të jashtëligjshme. Kur personi bëhet zotërues i një sendi në formë të jashtëligjshme, ky detyrim përlllogaritet për të gjithë periudhën në të cilën personi ka gëzuar frytet e kësaj pasurie”.

përket shkresës së DRT-së Fier (paragrafi 13.19 më sipër), është sqaruar se verifikimet janë kryer duke iu referuar sistemit tatimor *online*, si dhe dosjeve që gjenden në arkivin e kësaj DRT-je, duke nënkuptuar këtu se informacioni i kërkuar nga Komisioni i është nënshtruar edhe kërkit manual nga kjo drejtori, pasi periudha daton e hershme dhe dihet që bazat e të dhënave *online* janë të vonshme, kryesisht pas vitit 2019. Duhet theksuar fakti se shkresa e Bashkisë Lushnje, cituar në paragrafin 13.19 më sipër, e cila përmban informacionin e institucionit që ka administruar tregun e fruta-perimeve, sqaron se është i pamundur identifikimi i tatimpaguesve para vitit 2012, pasi nuk ka pasur një sistem të mirëfilltë për mbajtjen e të dhënave për tatimpaguesit, duke lënë vend për dyshime se jo çdo tatimpagues i është nënshtruar regjistrimit *online* ose në *excel*, sidomos para vitit 2012, periudhë e cila i përket edhe nevojës për verifikimin e pagesës së detyrimeve tatimore të nënës së subjektit nga ana e Bashkisë Lushnjë. Në këto kushte, kjo përgjigje e Bashkisë Lushnjë nuk provon që nëna e subjektit të rivlerësimit të ketë paguar detyrimet tatimore që i përkasin aktivitetit të saj tregtar.

13.23 Lidhur me pagesat që prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë kryer për shlyerjen e apartamentit me sip. 120 m², të cilat përbëjnë: (i) kalimin në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK, të shumës prej 3.001.500 lekësh¹⁴ në datën 01.12.2015; (ii) pagesën tjetër në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, në shumën prej 1.260.000 lekësh, e kryer nga nëna e subjektit pas maturimit të depozitës; si dhe (iii) pjesën tjetër të dhënë nga prindërit në *cash* subjektit të rivlerësimit, për të mbuluar shpenzimet që u krijuan nga blerja e apartamentit, të cilat në total bëjnë shumën prej 5.000.000 lekësh, trupi gjykues vëren si në vijim.

13.24 Nga konfirmimi¹⁵ i Bankës së Shqipërisë, nëna e subjektit të rivlerësimit, deri në datën 31.12.2003, rezulton se ka investuar në bono thesari shumën prej 940.134 lekësh. Kjo depozitë, deri në dhjetor të vitit 2014, është rritur vit pas viti, duke arritur vlerën 3.000.000 lekë, pra që nga viti 2003 është shtuar në shumën 2.059.866 lekë, të ardhura këto të cilat janë përfituar nga nëna e subjektit të rivlerësimit nga investimi në këtë bono thesari. Nga kjo depozitë, vërehet se që nga viti 2003, investimi ishte në shumën 940.134 lekë, në vitin 2014 ka arritur vlerën 3.000.000 lekë, e cila duket se është riinvestuar në vazhdimësi me të ardhurat nga interesat e kësaj depozite. Trupi gjykues, ashtu si dhe Komisioni, vlerësoi faktin se investimi në bono thesari në vitin 2003 nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, i cili ka gjeneruar të ardhura nëpërmjet interesave bankarë, dhe është riinvestuar deri në vitin 2015, që i është dhënë huaja subjektit të rivlerësimit për shlyerjen e këstit të parë për blerjen e apartamentit, konfirmon faktin se ky investim ishte i prindërve të saj, duke shmangur çdo dyshim se këto të ardhura derivojnë nga të ardhura të paligjshme nga funksioni i subjektit të rivlerësimit si gjyqtare.

Ndërsa, sa i përket depozitës së krijuar në Bankën Kombëtare Tregtare nga nëna e subjektit të rivlerësimit në vitin 2006 dhe e përdorur në vitin 2015, për pagesën e këstit të dytë të apartamentit të subjektit të rivlerësimit, në shumën 1.260.000 lekë, ka rezultuar se nëna e subjektit të rivlerësimit

¹⁴ Pranë Bankës së Shqipërisë janë maturuar më datë 12.11.2015, bonot e thesarit që i përkasin nënës së subjektit, në shumën 2.993.128 lekë, të cilat më pas janë kredituar në llogarinë e saj personale në ABI Bank e nga ku në datën 01.12.2015, është kryer pagesa në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, në vlerën 3.001.500 lekë.

¹⁵ Shkresa e Bankës së Shqipërisë nr. {***} prot., datë 18.05.2020.

ka hapur llogarinë bankare me nr. {***}, në datën 06.11.2006. Në këtë llogari, janë depozituar dhe tërhequr *cash* shuma të ndryshme nga nëna e subjektit të rivlerësimit në vazhdimësi. Komisioni nuk e ka përfshirë në analizë këtë depozitë, madje nuk ka kryer një analizë të detajuar për burimin e krijimit të saj. Nga verifikimi i ushtruar nga Kolegji për këtë depozitë, ka rezultuar se ajo ka pësuar ndryshime nga tërheqjet dhe depozitimet *cash* të njëpasnjëshme në historikun e kohëzgjatjes së saj, duke e bërë të pamundur evidentimin e burimit të secilit depozitim dhe destinacionin e secilës tërheqje nga depozita.

13.25 Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, ushtroi kontrollin ndaj analizës financiare të kryer nga Komisioni, për të analizuar mundësinë e krijimit nga ana e prindërve të subjektit, të kursimeve që kanë shërbyer për dhënien e huasë subjektit të rivlerësimit, në shkurt të vitit 2010, kohë në të cilën i kanë dhënë huanë subjektit për blerjen e automjetit, e cila do t'i nënshtrohet një vlerësimi të dedikuar në vijim të këtij vendimi, deri në vitin 2015, në të cilin kanë dhënë huanë për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi. Në këtë analizë, u morën në konsideratë vetëm të ardhurat e ligjshme të krijuara nga punësimi i babait të subjektit të rivlerësimit deri në vitin 2013, të ardhurat nga shlyerja¹⁶ e huasë nga ana e subjektit të rivlerësimit, dhënia e huasë në formën *cash*, në shumën 740.000 lekë, në vitin 2015, për blerjen e apartamentit 120,3 m². Gjithashtu, në depozitën e BKT-së, në Kolegj u kontrollua vetëm shuma e investuar, pa përfshirë interesat (943.514 lekë), ndërsa konsiderimi si e ardhur iu bë të gjithë shumës së kësaj depozite (1.260.000 lekë), përfshirë edhe interesat. Nga kjo analizë, trupit gjykues i rezultoi se për periudhën 2010-2015, prindërit e subjektit të rivlerësimit rezultonin me një balancë negative, në shumën -395.096 lekë.

13.26 Trupi gjykues vlerësoi lidhur me deklarinë e subjektit të rivlerësimit për burimin e krijimit të pasurisë apartament, objekt shqyrtimi, i cili nuk ka deklaruar si burim të blerjes së këtij apartamenti, huanë prej 5.000.0000 lekësh, të marrë nga prindërit, në deklaratën e pasurisë *vetting*. Sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti kishte detyrimin të shpjegonte bindshëm burimin e ligjshëm që ka shërbyer për blerjen e këtij apartamenti. Trupi gjykues, referuar deklarinë me sipër, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer pasaktësi në deklaratën e pasurisë *vetting*, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, duke qenë se nuk ka deklaruar plotësisht dhe saktësisht burimin e krijimit të kësaj pasurie. Referuar lëvizjeve bankare dhe parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes për kryerjen e pagesave për blerjen e apartamentit, rezulton se ka përputhshmëri të pagesës së kësteve. Në deklarinë e saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, ka qenë koherente për mënyrën e deklarinë të burimit të krijimit të apartamentit si në deklaratën periodike vjetore 2015, edhe në atë *vetting*.

Trupi gjykues vlerëson se pavarësisht kohës së plotësimi të deklarinë së pasurisë *vetting*, huaja ishte shlyer nga subjekti në vitin 2016, ndaj duhet ta kishte deklaruar këtë hua, edhe pse ajo nuk ekzistonte më. Kjo pasaktësi e subjektit nuk kishte qëllim fshehjen e ndonjë fakti, apo tendencë për të kryer deklarim të rremë, duke qenë se subjekti i rivlerësimit jo vetëm e kishte deklaruar

¹⁶ Shlyerja e huasë vit pas viti, sipas deklarinëve në DIPP-të përkatëse të subjektit të rivlerësimit, të shumës prej 1.800.000 lekësh, që ka shërbyer për blerjen e automjetit.

marrjen e kësaj huaje në DIPP-në e vitit 2015, si dhe shlyerjen e saj nëpërmjet kredisë së marrë në vitin 2016, por gjithashtu rezultoi e provuar se kredia e marrë është kaluar tërësisht në llogarinë bankare të prindërve, për pasojë nuk u vlerësua nga trupi gjykues si pasaktësi që të kishte peshë në vlerësimin e pasurisë së subjektit.

13.27 Lidhur me të ardhurat nga qiratë, të deklaruara si burim krijimi të apartamentit me sip. 120,3 m², sipas dokumentacionit të administruar në dosje, ka rezultuar se në deklaratën *vetting*, në seksionin e të ardhurave, personi i lidhur ka deklaruar: *Të ardhura nga qiraja nga pasuria me nr. {***}, Tiranë, në shumën 19.454 euro*. Ndërsa në seksionin e pasurive, në deklaratën *vetting*, personi i lidhur ka deklaruar: “Apartament me sip. 90 m², Tiranë, fituar me cedim kontrate, sipas kontratës së vitit 2012 dhe i regjistruar në vitin 2015”. Të ardhurat nga qiraja e këtij apartamenti janë deklaruar nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, në periudhat 2009 – 2011 dhe 2014 – 2016”.

13.28 Lidhur me këto të ardhura të deklaruara si burim krijimi i apartamentit objekt kontrolli, Komisioni ka arsyetuar se: “(i) Neni 144 i Kodit Civil parashikon se: *Sendet e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to regjistrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme*”. (ii) *Titullari i së drejtës se pronësisë, ka në të njëjtën kohë edhe tagrin e përfitimit të fryteve civile dhe natyrore të sendit, si qiraja nga dhënia me qira e pronës së paluajtshme – fryte civile*. (iii) *Pronësia dhe posedimi janë gjendje juridike të ndryshme nga njëra-tjetra. Ndërsa pronësia përfaqëson një situatë juridike mbi sendin, posedimi përfaqëson situatën reale dhe faktike të subjektit mbi sendin*. (iv) *Posedimi është pikërisht sundimi dhe pushteti efektiv, faktik mbi sendin. Ligjërisht, pronari është dhe duhet të jetë edhe posedues faktik mbi sendin. Ai sundon sendin efektivisht dhe faktikisht, por mund të ndodhë që poseduesi i sendit nuk është pronar i tij. Referuar së drejtës sonë civile, posedimi është një e drejtë që mund të ushtrohet dhe nga personi, i cili nuk është pronar i sendit, por ka të drejtën e posedimit të tij në bazë të një marrëveshjeje me pronarin (si marrëveshje qiraje, uzufukti, emfiteoze etj., ose posedon sendin në bazë të një akti administrativ)*. (v) *Në analizë të dispozitave ligjore, titulli i pronësisë kërkon të pasurit kumulativisht të tagrit të gëzimit dhe disponimit lirisht të sendeve*.

13.29 Komisioni, përgjatë hetimit administrativ, ka pyetur subjektin e rivlerësimit në pyetësorin nr. 2, në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament në rr. “{***}” dhe në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: [...] *apartamenti në fjalë ka qenë i premtuar për t’i kaluar babait të bashkëshortit, vjehrrit tim, të ndjerit E. H., me profesion avokat, nga bashkëpronarët e familjes A., për efekt të përfaqësimit të interesave të tyre në konfliktin që ata kishin pikërisht në lidhje me truallin ku ishte ngritur ndërtesa, ku gjendet ky apartament [...]. Megjithatë, duke qenë se vjehri ndërroi jetë më 24.08.2006, ky kalim nuk u bë i mundur, edhe për shkak se apartamentet e përfituara nga familja A. në ndërtesë, në dijeninë e bashkëshortit tim, nuk ishin ndarë mes tyre. Në vijim të premtimit që familja A. i kishte bërë vjehrrit tim, por edhe për shkak të gjykimit midis tyre dhe një pale të tretë, ata kërkonin që bashkëshorti të vijonte përfaqësimin e çështjes, dhe në mars të vitit 2009, familja A. i dorëzoi atij çelësat e apartamentit në fjalë. [...] Më pas, në korrik të vitit 2015, u bë e mundur që të lidhej një marrëveshje me shoqërinë “{***}”, ku u caktuan pjesët*

që u kalonin pronarëve, përfshi edhe bashkëshortin tim që pronarët ia kishin ceduar një pjesë të drejtave të tyre. Për ta regjistruar apartamentin në këtë rast, u detyruam të paguanim një shumë të konsiderueshme prej 2,1 milionë lekësh, si tatim për kalimin e pronësisë.

13.30 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultoi se apartamenti me sip. 90 m², me nr. pasurie {***}, ndodhur në Tiranë, është i regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Ky regjistrim është kryer më datë 14.10.2015, mbi bazën e aktmarrëveshjes për cedim kontrate me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 17.12.2012. Në kartelën e kësaj pasurie, në seksionin “Shënime”, është shkruar: “Akt marrëveshje për cedim kontrate nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2012”. Trupi gjykues vëren se kjo aktmarrëveshje, me palë trashëgimtarët e familjes A., i kalon/cedon z. E. H. të gjitha të drejtat e fituara prej tyre në saje të kontratës nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 25.10.1997, në lidhje me një apartament prej 90 m², ndodhur në katin e shtatë të ndërtesës së ngritur sipas kontratës më sipër. Trashëgimtarët pranojnë se ky apartament i është vënë në posedim z. E. H. që prej datës 01.03.2009. Kjo aktmarrëveshje realizohet për arsye se trashëgimtarët (babai) i z. E. H., av. E. H., për këtë konflikt, për disa vite ka përfaqësuar interesat e trashëgimtarëve të familjes A. në disa procese gjyqësore civile. Për efekt të këtyre shërbimeve, ka qenë marrëveshje midis palëve që të drejtat e trashëgimtarëve të familjes A. për një apartament, në momentin e realizimit të tyre, t’i kalonin të ndjerit, av. E. H.. Në aktmarrëveshje parashikohet se përdorimi i këtij apartamenti nga z. E. H. dhe të ardhurat e krijuara për shkak të këtij përdorimi, konsiderohen të autorizuara nga trashëgimtarët e familjes A. dhe në lidhje me to, nuk kanë asnjë pretendim në të ardhmen. Gjithashtu, parashikohet se nëse për shkak të konflikteve gjyqësore, trashëgimtarët e familjes A. nuk arrijnë të fitojnë pronësinë mbi apartamentet ose humbasin posedimin mbi to, të njëjtin fat pëson edhe apartamenti objekt marrëveshjeje. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga trashëgimtarët e familjes A., si dhe nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. E. H..

13.31 Trupi gjykues vëren se bashkëngjitur aktmarrëveshjes së cituar në paragrafin më sipër, gjendet deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.07.2015, sipas së cilës deklaruesi A. U., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, deklaroi se bashkëpronarët e familjes A. do të përfitonin disa apartamente banimi në bazë të marrëveshjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.10.1997, kontratës së dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.12.1998, lejes së ndërtimit të dhënë nga KKRRT e Bashkisë Tiranë, nëpërmjet vendimit nr. {***}, datë 21.02.1998, si dhe projektit “{***}”. Sa më sipër, në zbatim të këtyre akteve dhe në përmbushje të detyrimeve të parashikuara prej tyre, në përfundim të ndërtimit të objektit, shoqëria “{***}” ShPK u ka dorëzuar bashkëpronarëve të familjes A., pasuritë e paluajtshme që do të përfitoheshin prej tyre nga ndërtimi i objektit.

13.32 Në një tjetër deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.7.2015, ku nënshkruer janë z. A. U. dhe trashëgimtarët e z. Ll. A., citohen të njëjtat të drejta dhe detyrime të cituara në deklaratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.07.2015, por përveç tyre deklarohet edhe se bashkëpronarët e familjes A., me vullnetin e tyre të lirë, deklaruan se kanë marrë në

dorëzim nga shoqëria “{***}” ShPK, pasuritë e ndara respektivisht ndërmjet tyre. Nga këto pasuri, deklarohen se i kanë dorëzuar z. E. H., apartamentin në fjalë me nr. pasurie {***}.

13.33 Pas administrimit të dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni konstatoi se aktmarrëveshja për cedim të drejtash, e lidhur në vitin 2012 ndërmjet familjes A. dhe personit të lidhur me subjektin, ka në objekt rregullimin me efekt prapaveprues të kalimit të të drejtave të sipërmarrjes sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.10.1997, të një apartamenti me sip. 90 m², të ngritur mbi një truall të ndodhur në kryqëzimin e rr. “{***}” me rr. “{***}”, si dhe rregullimin me efekt prapaveprues të tagrave të posedimit dhe gëzimit të apartamentit nga personi i lidhur me subjektin.

13.34 Trupi gjykues vëren se nga sqarimet e subjektit të rivlerësimit, dhënë në Komision, si dhe nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se në vitin 2012, nëpërmjet aktmarrëveshjes për cedim të drejtash, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit i kalojnë një apartament trashëgimtarët e familjes A., pasi vjehri i subjektit të rivlerësimit, ka mbrojtur gjyqësisht interesat e kësaj familjeje. Sipas aktmarrëveshjes, trashëgimtarët e familjes A. pohojnë se ky apartament i është vënë në posedim z. E. H. që prej datës 01.03.2009. Ndërkohë, bashkëshorti i subjektit që në DIPP-në e vitit 2009 ka deklaruar të ardhura të cilat i ka përfituar nga dhënia me qira e këtij apartamenti, të cilin e ka përfituar nga familja A.. Më pas, më datë 14.10.2015, ky apartament është regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Për regjistrimin e kësaj pasurie, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka paguar në rrugë bankare për ZVRPP-në Tiranë, tatimin për kalimin e pronësisë, sipas aktmarrëveshjes së lidhur me trashëgimtarët e familjes A., si dhe taksat për regjistrimin e saj, në shumën 2.100.000 lekë, shpenzim të cilin e ka deklaruar edhe në DIPP-në e vitit 2015.

13.35 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit, për të paraqitur shpjegime dhe prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit, duke konstatuar se:

i) Nuk janë deklaruar të drejtat reale të personit të lidhur mbi pronësinë e pasurisë apartament në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, të drejtat që kanë lindur nga aktmarrëveshja për cedim kontrate në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, si dhe pronësia mbi apartamentin në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015.

ii) Në lidhje me gëzimin e këtij apartamenti dhe frytet e tij (të ardhura nga qiraja), nuk provohet burimi i ligjshëm i këtyre të ardhurave për sa personi i lidhur nuk kishte vetë tagra ligjorë ta jepte me qira apartamentin, dhe për sa duket se personi i lidhur me subjektin nuk e ka përfituar apartamentin në asnjë nga mënyrat ligjore të fitimit të pronësisë dhe as të ketë pasur tagra posedimi dhe gëzimi të ligjshme mbi atë pasuri.

iii) Aktmarrëveshja për cedim kontrate e vitit 2012, nuk duket të ketë sjellë pasoja ligjore me efekt prapaveprues edhe mbi marrëdhëniet e mëparshme (qiratë nga viti 2009), për sa Kodi Civil nuk parashikon lidhjen e marrëdhënieve me efekt prapaveprues, përveç rasteve të zgjidhjes së kontratës për mospërbushje të detyrimeve sipas nenit 703 të Kodit Civil.

13.36 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “[...] doktrina më e shquar e kohës: "Nëse një person është pronar i truallit, ndërsa një tjetër ka të drejtën ekskluzive

mbi ndërtesat dhe mbjelljet që lidhen me truallin, ky i fundit ka të drejtën e sipërfaqes, që përcaktohet ndonjëherë me emrin sipërfaqësore". [...] E drejta e sipërfaqes është një servitut, një barrë, një e drejtë reale mbi sendin e tjetrit (*ius in res aliena*) dhe për këtë shkak ajo regjistrohet. Si servitut, ajo është njohur historikisht në doktrinën romano-gjermanike, megjithëse rregullimi normativ i saj ka qenë i ndryshëm. Edhe sot ka kode civile, si ai italian apo zviceran, të cilët e parashikojnë shprehimisht të drejtën e sipërfaqes. Megjithatë, e drejta e një të treti për të përdorur dhe për të ngritur ndërtime të tijat mbi truallin e pronarit, në saje të marrëveshjes ku pronari ruan të drejtën e pronësisë mbi truallin, dhe ndërtuesi pronësinë mbi ndërtesën, quhet e drejtë e sipërfaqes. Ajo rregullohet, mbrohet dhe zhvillohet si një trajtim i parimit se ajo çka ngrihet mbi sendin, është e pronarit të sendit, një parim ky që është tërësisht natyral për sendet e paluajtshme”.

13.37 Meqenëse Komisioni ka konkluduar në vendim se trashëgimtarët A. kanë pasur vetëm të drejta përdorimi mbi truallin dhe se nuk kanë pasur tagra gëzimi e disponimi lirisht të truallit, për shkak të konflikteve gjyqësore me trashëgimtarët e S. P., me qëllim që të kuptohet natyra e të drejtave që trashëgimtarët A. kishin mbi truallin e ndodhur në rr. “{***}”, trupi gjykues, në mungesë të dokumentacionit që i përket dosjes gjyqësore të konfliktit ndërmjet familjeve P. dhe A., vlerësoi të përmbledhë disa fakte të cilat dalin nga vendimi nr. {***}, datë 25.01.2013, i Gjykatës së Apelit Tiranë, përmendur edhe në ankimin e subjektit të rivlerësimit, lidhur me konfliktin ndërmjet trashëgimtarëve të S. P. dhe trashëgimtarëve të Ll. A.. Nëpërmjet këtij vendimi, Gjykata e Apelit Tiranë ka ndryshuar vendimin¹⁷ e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke rrëzuar kërkesëpadinë e trashëgimtarëve¹⁸ të S. P..

13.38 Pasi janë njohur me vendimin e KKKP-së, cituar në paragrafin më sipër, trashëgimtarët e S. P. i janë drejtuar KKKP-së, ku kjo e fundit, me vendimin nr. {***}, datë 04.10.1995, ka vendosur të njohë S. P. ish-pronar të një prone të përbërë nga një truall me sip. 1300 m², pas 99 vjetësh, sipas kontratës së qirasë. Trualli i lirë, me sip. 1035 m², i njihet dhe rikthehet pronarit pas 99 vjetësh, sipas kontratës së qirasë. Truallin e zënë me ndërtime të përhershme (pallat 5 kate, me sip. 253 m²) t’i kompensohet pronarit. Në vitin 2001, trashëgimtarët e S. P. çelin proces gjyqësor (cituar në poshtëshënimin nr. 17 më sipër), proces i cili u pushua me vullnetin e paditësve. Në vitin 2009, sërish familja P. fillon një proces gjyqësor, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të KKRRT-së nr. {***}, datë 04.10.1995. Ky proces finalizohet me vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tiranë, me nr. {***}, datë 25.01.2013 (cituar në paragrafin më sipër). Kundër këtij vendimi, kanë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë trashëgimtarët e S. P., ku kjo gjykatë me vendimin nr. {***}, datë 29.06.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit të

¹⁷ Vendimi nr. {***}, datë 16.04.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁸ Trashëgimtarët e S. P., në vitin 2009 kanë çelur një proces gjyqësor kundër trashëgimtarëve A., pasi këta të fundit kishin lidhur marrëveshjen me shoqërinë e ndërtimit për të ndërtuar apartamentin në truallin e marrë me qira, duke kërkuar të njihen si pronarë mbi truallin dhe mbi gjithë objektin e ndërtuar. Në këtë proces gjyqësor, familja A. është përfaqësuar nga av. E. H.. Prosesi është zhvilluar në shkallë të parë ku është pranuar padia dhe, me ankimin e palës së paditur, çështja zhvillohet në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila prish vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe kthen çështjen për rigjykim në këtë gjykatë. Pas disa seancash, kjo çështje pushohet me vullnetin e palës paditëse, familjes P..

paraqitur nga paditësit. Në vitin 2017, trashëgimtarët e S. P. ankohen në Gjykatën Kushtetuese, e cila me vendimin nr. {***}, datë 10.11.2017, vendosi rrëzimin e kërkesës së tyre.

13.39 Trupi gjykues vëren se nga shqyrtimi i dokumentacionit bankar të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në Intesa San Paolo Bank, rezultoi se llogaria e tij është kredituar që nga muaji qershor 2009 e në vazhdim, në mënyrë periodike, me përshkrime të cilat lidhen me pagesën e qirasë. Nga këto kreditime në llogarinë bankare, rezulton se të ardhurat e qirasë për vitin 2009, janë në shumën 2.100 euro; për vitin 2010, janë në shumën 3.600 euro; për vitin 2011, janë në shumën 2.350 euro; për vitin 2012, nuk ka pasur kreditime në formën e qirasë; për vitin 2013, janë në shumën 921 euro; për vitin 2014, janë në shumën 3.793 euro; për vitin 2015, janë në shumën 4.190 euro dhe për vitin 2016, janë në shumën 4.400 euro.

13.40 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision, shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me nr. {***}, datë 27.01.2021, sipas së cilës sqarohet se subjekti “{***}”, me NIPT {***}, e cila kishte me qira ambientin e apartamentit në fjalë, ka paguar tatim në burim për periudhën qershor 2009 - korrik 2011. Po sipas kësaj shkrese, z. E. H. ka paguar tatim në burim mbi qiranë në datën 06.08.2013, në shumën 82.237 lekë. Në vijim të kësaj shkrese, specifikohet se “{***}”¹⁹ ShPK, për periudhën 2014 ka paguar tatimin në burim mbi qiratë, në shumën 57.913 lekë, dhe gjithashtu tatimi në burim është kryer edhe për periudhën janar 2015 - dhjetor 2016. Nga përgjigjja e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, drejtuar Komisionit nëpërmjet shkresës me nr. {***} prot., datë 29.05.2020, sqarohet se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. E. H., është regjistruar si individ privat për deklaratën individuale vjetore të të ardhurave (DIVA), duke deklaruar të ardhura nga qiraja, si dhe ka paguar tatimin mbi qiranë që nga viti 2011 deri në vitin 2016. Nga sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të rregullt në deklaratat periodike të pasurisë, të ardhurat e përfituara nga qiratë. Nga dokumentacioni bankar, rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka përfutur të ardhura nga qiraja në llogarinë e tij bankare që nga viti 2009 deri në vitin 2016, si rrjedhojë rezulton se për këto të ardhura, janë likuiduar detyrimet tatimore.

13.41 Në analizë sa më sipër, trupi gjykues bazoi vlerësimin në aktet e përpiluara nga familja A. me investitorin e ndërtimit dhe aktet e tjera që dëshmojnë për një vullnet për kalim pronësie nga familja A. në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues vëren se nga pronarët e ndërtimit, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit i është dhënë apartamenti në posedim në vitin 2009. Në vitin 2012, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka lidhur aktmarrëveshjen për kalim të drejtash nga trashëgimtarët A. për apartamentin objekt shqyrtimi, nëpërmjet së cilës është kryer edhe regjistrimi në vitin 2015 pranë ZVRPP-së Tiranë, gjë e cila ka konfirmuar edhe posedimin e tij të ligjshëm nga viti 2009, vit kur e ka dhënë me qira apartamentin, të ardhurat e të prej së cilës subjekti i ka deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

¹⁹ Në dokumentacionin e administruar në dosje, gjendet një kontratë qiraje e datës 01.12.2013, e lidhur mes bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe z. E. D., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK. Vlera e qirasë mujore sipas kësaj kontrate, specifikohet në shumën 350 euro. Bashkëlidhur kësaj kontrate, gjenden urdhërpagesat për tatimin e mbajtur në burim.

13.42 Trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit për moskonsiderimin e këtyre qirave të ligjshme, jo për shkak të mospagimit të detyrimeve tatimore për këto të ardhura, por për arsye se trashëgimtarët e familjes A., të cilët i kanë kaluar të drejtat e posedimit personit të lidhur, nuk kanë pasur tagra për të gëzuar dhe disponuar lirisht truallin dhe pallatin mbi të, për shkak të konflikteve gjyqësore të pronësisë me trashëgimtarët e familjes P., është i gabuar, pasi bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit provohet me dokumentacion ligjor se ka qenë në kushtet e posedimit të ligjshëm të apartamentit me sip. 90 m², si rrjedhojë të ardhurat e realizuara nga dhënia me qira e këtij apartamenti, për të cilat rezultojnë të jenë paguar detyrimet tatimore dhe që kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit 120,3 m², janë të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, në drejtim të verifikimit të ligjshmërisë së titullit të pronësisë mbi këtë pasuri, trupi gjykues e sheh me vend të nënvizojë faktin se të drejtat mbi këtë pasuri, të fituara nga personi i lidhur, burojnë fillimisht nga kontributi i babait të tij si avokat i familjes A. në çështjen gjyqësore që ka zgjidhur konfliktin mbi pronësinë e pasurisë truall në favor të kësaj familjeje, kontribut i finalizuar prej personit të lidhur pas ndërrimit jetë të babait të tij. Përveç këtij fakti, rezulton se edhe në versionin se kjo pasuri do të përfaqësojë një të ardhur të krijuar prej punës si avokat të personit të lidhur, rezulton se ai i është nënshtruar tatimit mbi fitimin nëpërmjet pagimit të tij pranë ZRPP-së, në momentin e regjistrimit të pronës në emër të tij, duke plotësuar në këtë mënyrë edhe kriterin ligjor të së ardhurës/pasurisë së ligjshme sipas parashikimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, fakti që ky apartament rezulton i regjistruar në zyrën e pasurive të paluajtshme në emër të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, dëshmon marrëdhënien e finalizuar sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se konkluzioni i Komisionit për të mos i konsideruar të ardhurat nga qiraja, gjendet i pabazuar.

13.43 Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit lidhur me pasurinë “apartament banimi, me sip. 120,3 m²”, ndodhur në Tiranë, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, ka kryer pasaktësi në deklaratën e pasurisë *vetting*, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, duke qenë se nuk ka deklaruar huanë e marrë nga prindërit e saj si burim për krijimin e kësaj pasurie. Lidhur me të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e apartamentit me sip. 92 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, u konsideruan nga trupi gjykues si të ardhura me burime financiare të ligjshme. Lidhur me burimin e krijimit të huasë prej 5.000.000 lekësh, që ka shërbyer për pagesën e kësteve për likuidimin e kësaj pasurie, rezultoi një diferencë negative në shumën -395.096 lekë, e cila nuk u konsiderua me peshë nga trupi gjykues për ta kualifikuar si mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të krijuar këtë shumë në kuadër të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 14.** *Lidhur me automjetin, tip “Ford Kuga”, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk provoi burimin e ligjshëm të huasë 1.800.000 lekësh, përdorur si burim krijimi për blerjen e automjetit, është i gabuar. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se shuma prej 1.800.000 lekësh, e cila ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë*

automjet, tip “Ford Kuga”, është pjesë e të ardhurave të ligjshme të prindërve, të cilat kanë mundësuar dhënien e kësaj huaje.

14.1 Komisioni ka konsideruar këtë pasuri me efekt në shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, mbi bazën e konkluzionit se: *Për pasurinë, automjet “Ford Kuga”, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë “vetting” lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, pasi nuk provoi burimin e ligjshëm të huasë 1.800.000 lekë, përdorur si burim krijimi në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germat “a”, “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*

14.2 Trupi gjykues vëren se në dosjen e DPSHTRR-së, të administruar nga Komisioni, gjendet fatura tatimore e shitjes së automjetit me nr. {***}, datë 26.02.2010, lëshuar nga pala shitëse “{***}”, me çmimin 23.900 euro. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* se: “makina, tip “Ford KUGA”, është blerë në vitin 2010 nga “{***}”, çmimi: 23.900 euro”. Siç vërehet në deklaratën *vetting*, nuk është deklaruar burimi i krijimit të automjetit “Ford Kuga”, për vlerën e blerjes së tij në shumën 23.900 euro.

Në DIPP-në e vitit 2010, personi i lidhur ka deklaruar: “Blerje autoveture, tip “Ford KUGA”, në vlerën 23.900 euro, me burim: 8.140 euro kursime nga llogaria bankare në Intesa Sanpaolo, 2.160 euro kursime nga shitja e automjetit “Mercedes Benz”, 600 euro kursime nga të ardhurat, dhe 13.000 euro, ose 1.800.000 lekë, hua”. Në rubrikën “Detyrime financiare” të kësaj deklarate, personi i lidhur ka deklaruar: “Hua pa interes për blerje makine, në shumën 1.800.000 lekë, për një periudhë 5-vjeçare, nga H. B., babai i deklarueses. Shuma e shlyer deri në 31 dhjetor, 300.000 lekë, gjendja e detyrimit 1.500.000 lekë”.

14.3 Komisioni, lidhur me mosdeklarimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *vetting*, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, pasi bashkëshorti i saj në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk ka deklaruar burimin e krijimit të këtij automjeti në pronësi të tij dhe huanë e përdorur si burim krijimi. Lidhur me huanë në vlerën 1.800.000 lekë, përdorur si burim krijimi të automjetit, Komisioni ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar të kundërtën e barrës së provës mbi mundësinë e prindërve për krijimin e shumës 1.800.000 lekë, për huanë e dhënë bashkëshortit të subjektit, për arsye se pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerësimin si të ligjshme të të ardhurave të nënës si tregtare ambulante, nuk gjejnë mbështetje në dokumentacion. Subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion zyrtar që provon ushtrimin e aktivitetit tregtar ambulant nga nëna, por është përpjekur të provojë këtë fakt me deklaratat noteriale të individëve, të cilët pretendohet se kanë ushtruar aktivitetin e ambulantit në të njëjtën kohë me nënën e saj.

14.4 Trupi gjykues vëren se sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Gjithashtu, sipas pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, “pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të

paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2013, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, formulari i deklarin të pasurisë për rivlerësimin, “Shtojca 2” e ligjit nr. 84/2016, detyron subjektet e rivlerësimit për deklarin e të gjitha pasurive të akumuluar ndë vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat janë në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur. Në zbatim të këtij kuadri ligjor e kushtetues, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin që në deklaratën e pasurisë *vetting*, të deklaronte me saktësi pasuritë, si dhe burimet që kanë shërbyer për krijimin e tyre. Nga kontrolli që Kolegji ushtroi ndaj analizës financiare të kryer nga Komisioni, rezultoi se lidhur me burimin e krijimit të huasë dhe mundësinë e dhënies nga prindërit të shumës prej 1.800.000 lekësh, që ka shërbyer për pagesën e automjetit, tip “Ford Kuga”, blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, rezultoi një diferencë negative në shumën 1.185.479 lekë.

14.5 Në përfundim të analizës së shkakut të ankimit lidhur me automjetin, tip “Ford Kuga”, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, për shkak se nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Lidhur me burimin e krijimit të huasë prej 1.800.000 lekësh, që ka shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, nga kontrolli që ushtroi Kolegji në analizën financiare të kryer nga Komisioni, rezultoi një diferencë negative në shumën 1.185.479 lekë, e cila e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet mungesës së burimeve financiare të ligjshme në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

15. Këto problematika të konkluduara nga trupi gjykues, për faktin se balanca negative vjen si shkak i pamundësisë së subjektit të rivlerësimit të provojë burimet e ligjshme të personave të tjerë të lidhur sipas standardeve të këtij procesi dhe jo si pasojë e analizës financiare të kryer për kontrollin e burimeve të tij të financimit, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk u vlerësuan të mjaftueshme për të konsideruar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
16. Për vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, sipas vendimit të Komisionit, ka rezultuar se ka një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.
17. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore të përbërë nga aktet e përcjella në Kolegj nga Komisioni, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se vendimi nr. 364, datë 02.04.2021, i Komisionit të Pavarur të

Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i pambështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Hicka.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 364, datë 02.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Hicka.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 26.10.2023.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi – kundër

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtarja Rezarta Schuetz, nuk isha dakord me vendimin e shumicës që ndryshoi vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Hicka. Në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në kriterin e vetëm për të cilin ishte shkarkuar dhe, për pasojë, vendimi objekt ankimi duhet të ishte lënë në fuqi. Në vijim shtjellohet arsyetimi mbi të cilin mbështetet qëndrimi im.

I. Konstatime përmbledhëse

2. Vendimi i Komisionit dhe masa disiplinore e shkarkimit bazohet në kontrollin e disa pasurive të subjektit. E gjej me rëndësi të theksoj para së gjithash se Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit gjatë kohës kur ka qenë e komanduar në funksionin e Avokates së Shtetit në vitet 2013 – 2018, në kundërshtim me ligjin nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për avokaturën e shtetit”. Ky konstatim mbështetet edhe në vlerësimin e institucionit të specializuar për këtë vlerësim, Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurisë e Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”). Pavarësisht nga analiza e mësipërme, në pikën fundore, Komisioni ka zgjedhur të anashkalojë këtë konstatim me rëndësi me një arsyetimin sipërfaqësor, të pabazuar në ligj, se ushtrimi i detyrës në kushtet e konfliktit të interesit, “ishte një veprimtari jashtë objektit të veprimtarisë së ligjit nr. 84/2016” që, sipas trupit gjykues të Komisionit: “[...] nuk mund të shërbejë si shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit²⁰”.
3. Vlerësoj se ky qëndrim bie ndesh haptazi me frymën dhe parashikimet e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pasi, së pari, gjatë kohës që kryente detyrën e Avokates së Shtetit, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, ruajti statusin e gjyqtares, në sajë të të cilit u kthye në gjyqësor menjëherë pasi u lirua nga ajo detyrë. Sjellja e magjistratëve edhe *jashtë ushtrimit të funksionit* i nënshtrohet kontrollit në drejtim të identifikimit të sjelljeve që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Së dyti, ligji për statusin, për arsye të vetëkuptueshme, dikton që gjatë komandimit, magjistratët kanë të njëjtat të drejta e detyra sikurse gjatë ushtrimit të detyrës²¹, sikurse edhe magjistratët e tjerë. Për pasojë, përpos detyrimeve që mbante subjekti për shkak të detyrës ku ishte komanduar – të cilat rezultojnë t’i ketë shkelur – Komisioni duhet të kishte analizuar e marrë vendim në procesin e rivlerësimit edhe për normat etike, përfshirë mënjanimin e konfliktit të interesit, sipas nenit 73, pika 4 e ligjit të statusit. Institucionet e rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin, i kanë vlerësuar rregullisht subjektet e rivlerësimit edhe në kontekstin e kontrollit të

²⁰ Faqe 34 e vendimit të Komisionit, par. 21.55: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2021/07/Vendim-Alma-Hicka.pdf>.

²¹ Neni 53, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.

kriterit të vlerësimit profesional. Siç deduktohet nga rezultatet e hetimit administrativ, në faqet 35-37, edhe vetë subjekti duket të ketë pasur të njëjtin arsyetim. Gjatë hetimit administrativ për kriterin e vlerësimit profesional, ajo ka përzgjedhur tri dokumente të hartuara prej saj gjatë kohës që kryente detyrën e Avokates së Shtetit në vitet 2015-2016, dhe jo vendime të hartuara prej saj gjatë kohës që ishte gjyqtare.

4. Arsyetimi më sipër paraqet rëndësi për të ilustruar përse në rastin e këtij subjekti, kthimi në detyrë për shkak dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit, nuk është i drejtë. Në këtë konkluzion kam në konsideratë që ndonëse ka konstatuar se bashkëshorti i subjektit apo zyra ligjore ku ai ushtronte detyrën e avokatit, kishte përfaqësuar palën kundërshtare në konfliktet ku ishte e paditur Republika e Shqipërisë, në ¼ e çështjeve gjatë kohës kur bashkëshortja përfaqësonte të paditurin – Republikën e Shqipërisë – Komisioni ka zgjedhur të mos identifikojë një mënyrë trajtimi të këtij problemi. Me rëndësi të veçantë ndër këto aspekte, është konstatimi i Komisionit se në 60 çështje, komunikuar shtetit shqiptar në janar 2014, pak muaj pas emërimit të saj si Avokate e Shtetit²², 25% e tyre kishin përfaqësues bashkëshortin e saj me studion e ligjore në të cilën ai zotëronte edhe 5% të kuotave. Po ashtu, në një të një të çështjeve gjyqësore, ku bashkëshorti ishte avokati i kontraktuar nga pala paditëse/kundërshtare, e cila kërkonte 8.000.000 euro dëmshpërblim nga shteti shqiptar, në cilësinë e avokates së shtetit shqiptar, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, ka qenë pjesë aktive e procesit të zhvilluar në vijim, duke hartuar edhe dispozitat e marrëveshjes që amnistoi penalisht drejtuesit e shoqërisë paditëse²³/klientët e bashkëshortit të saj.
5. Pavarësisht nga këto mangësi të vendimit të Komisionit, votova për lënien në fuqi të tij, më së paku për vlerësimin pasuror, si një tregues gjithsesi domethënës në vlerësimin tërësor të këtij subjekti. Vendimi objekt ankimi pasqyron edhe lëshime të tjera në vlerësimin e kriterit të pasurisë, në formë kontradiktash e vëmendjeje *disproporcionale* në marrëdhënie pasurore të shkuara, duke lënë në heshtje e duke mos identifikuar natyrën e vërtetë të rrethanave faktike, të cilat duhet të ishin korrigjuar. Trupi gjykues i Kolegji duhet të kishte vendosur theksin te natyra e vërtetë e problemeve, të cilat ekzistojnë, nuk u zhbënë nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Hicka, dhe e bënin të drejtë shkarkimin e saj nga detyra.

II. Vlerësimi i pasurisë

6. Komisioni ka konstatuar probleme për sa u përket dy pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin, analizuar në vijim, e konkretisht, një apartament në Tiranë dhe një automjet. Në vlerësimin tim, problematikat e konstatuara nga Komisioni ishin të atilla që duhet të passillnin lënien në fuqi të vendimit. Në vijim analiza e tyre, grupuar sipas problematikave në burimet e deklaruara të krijimit të tyre.

²² Në tetor 2013.

²³ Referuar në detaj në paragrafët 21.3, 21.4 dhe 21.5 të vendimit të Komisionit.

A. Pasuritë e krijuara me hua nga prindërit e subjektit të rivlerësimit

7. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me burimet e krijimit të një apartamenti në Tiranë, me sipërfaqe 120 m², dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj, sipas parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germat “a”, “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në vlerësimin tim, ky konkluzion, pavarësisht nevojës për të saktësuar problematikën ekzakte, duhet të mbahej në konsideratë. Edhe në analizën e kryer në Kolegj, subjekti rezulton të mos ketë identifikuar burimin e krijimit të këtij apartamenti me vërtetësi dhe ka mungesë burimesh të ligjshme. Ndaj qëndrim të ndryshëm nga shumica për peshën që duhet të merrte kjo deklaratë e pavërtetë e subjektit për burimin e krijimit të pasurisë dhe për balancën negative financiare të mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.
8. Apartamenti në fjalë është kontraktuar nga subjekti dhe personi i lidhur për vlerën 90.000 euro, me kontratë porosie të datës 14.05.2015. Subjekti ka deklaruar si burim krijimi “kredi” dhe “kursime nga paga”. Rezultoi që kredia, në vlerën 3 milionë lekë, është disbursuar në dhjetor 2016, një moment në të cilin subjekti kishte paguar 86 mijë euro, ose 95% të vlerës, pa përdorur kredinë. Me fjalë të tjera, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, ka deklaruar si burim krijimi, fonde të fituara/disbursuara asaj dhe personit të lidhur pasi ata kishin paguar thuajse gjithë çmimin e apartamentit, nëpërmjet burimeve të ndryshme dhe pa pasur nevojë për kredinë. Deklarata e pasurisë *vetting* është plotësuar një muaj pasi subjektit i ishte akorduar kredia. Në vlerësimin tim, dinamika e veprimeve dëshmon zgjedhje të subjektit për të mënjanuar huanë si burim apo kontrollin e burimeve të ligjshme të huadhënësve – prindërve të saj – dhe jo pasaktësi të thjeshtë apo harresë njerëzore. Ky fakt paraqet rëndësi të veçantë pasi subjekti ka deklaruar prindërit si burim krijimi i të paktën dy pasurive të analizuara, ndonëse në periudhat kohore përkatëse, ajo dhe bashkëshorti ishin të punësuar në detyra të mirëpaguara, ndërsa prindërit rezultuan me të ardhura krahasimisht modeste dhe investime të konsiderueshme. Në vlerësimin tim, deklarimi i kryer nga subjekti, duke nisur nga rrethanat konkrete të faktit, pasqyron pavërtetësi të qëllimshme që shkojnë përtej pasaktësisë.
9. Bazuar në deklaratimet e subjektit në deklaratën periodike vjetore për vitin 2015, Komisioni ka analizuar burimet e deklaruara në atë kohë, përfshirë huanë nga prindërit e subjektit, në vlerën 5 milionë lekë, dhe ka konstatuar pamundësinë financiare të tyre. Nga analiza e kryer në Kolegj, rezultoi po ashtu se prindërit e subjektit ishin në pamundësi për të dhënë huatë prej 740.000 lekësh *cash* dhe 1.260.000 lekë në vitin 2015 [si pjesë e vlerës prej 5 milionë lekësh]. Në një vështrim të përgjithshëm të depozitave bankare të përdorura nga prindërit e subjektit në funksion të transfertës në favor të shoqërisë së ndërtimit për apartamentin e subjektit, rezultojnë disa fakte. Së pari, depozitat janë ushqyer në mënyrë të konsiderueshme ndër vitet 2003-2014. Komisioni nuk ka kryer hetim në drejtim të verifikimit të burimeve të ligjshme për “ushqimin” e depozitave, ndonëse ka konstatuar se prindërit e subjektit nuk kishin burime të ligjshme për huanë në vlerën 5 milionë lekë. Në këto kushte, balanca negative e konstatuar në Kolegj për mundësinë e prindërve, nëse Komisioni do të kishte kryer një analizë rigoroze të të ardhurave në funksion të depozitave, mund

të ishte më e thellë. Duke e pranuar të mirëqenë për shkak garancish procedurale këtë analizë, edhe duke marrë në konsideratë deklaratimet për shlyerjen e një huaje tjetër [të vitit 2010], prindërit e subjektit rezultojnë me pamundësi financiare për të dhënë huanë subjektit në vitin 2015, me burime të ligjshme të provuara.

10. Fakti që transferta është kryer nëpërmjet bankës, provon vetëm që shoqëria e ndërtimit është paguar nëpërmjet bankës. Ky fakt nuk provon ligjshmërinë e burimeve të përdorura, sikurse as nuk konfirmon shpjegimet e subjektit për arsyet për të cilat janë kryer veprimet në mënyrën që janë kryer. Pretendimet e subjektit për gjithë dinamikën e veprimeve janë jobindëse. Në këtë konkluzion, përpos faktit që burimet me të cilat janë krijuar depozitat e prindërve nuk janë verifikuar për mundësinë e burimeve të ligjshme, mbaj në konsideratë edhe sa vijon: (i) subjekti pretendon të ketë marrë hua, të cilën e ka shlyer brenda vitit, duke marrë përsipër koston financiare të një kredie që shoqërohet natyrshëm me përqindje interesi. Palët në “marrëveshjen e huasë” kanë përcaktuar afat 5-vjeçar, pavarësisht nga marrëdhënia e posaçme mes tyre dhe sa ka rezultuar nga shlyerja në kohë rekord e huasë, brenda vitit në vijim. Këto rrethana ngrenë pyetje për arsyen e vërtetë për të cilën është marrë kredia, huaja ose të dyja, në kushtet që subjekti dhe personi i lidhur pretendojnë mundësi financiare për të shlyer sasi të konsiderueshme detyrimesh brenda harqesh kohore shumë të shkurtra; (ii) subjekti deklaroi si burim *kreditë* dhe jo huanë e prindërve, ndonëse në momentin kur është shlyer 85% e pagesës, kredia nuk ishte marrë; (iii) nuk ka gjurmë të shlyerjes së huasë, ndonëse ka gjurmë të lëvrimin të saj nëpërmjet bankës – pagesat nga nëna për apartamentin kryhen nëpërmjet bankës, kurse shlyerja e huasë kryhet në *cash*, ndonëse subjekti dhe bashkëshorti në vitin 2016, paguhen nëpërmjet sistemit bankar; (iv) pagesat e kryera deri në 1 qershor 2015 nëpërmjet bankës, përkohë ekzaktësisht me parashikimet kontraktore. Huaja nga ana tjetër, përbën një pagesë ekstra, të paparashikuar për atë vit dhe as detyrim të ngutshëm të subjektit ndaj shoqërisë ndërtuese. Për këtë arsye, edhe sjellja në tablo e një huaje për të mundësuar pagesë shtesë e përtej detyrimeve kontraktore, për shlyerjen e së cilës [huasë] më pas u nevojiti marrja e një kredie me interes, rezultoi e pashpjegueshme nga ana e logjikës financiare, përveçse në funksion të nevojës për të kanalizuar pagesë nëpërmjet besueshmërisë e gjurmueshmërisë që ofron një transaksion bankar për subjekte deklaruese, sipas ligjit nr. 9049/2003 apo ligjit nr. 84/2016.
11. Rrethanat e mësipërme, sidomos ato që lidhen me periudhën e shkurtër kohore brenda së cilës kanë ndodhur veprimet, tregojnë që nëse pranohet që në fakt burim krijimi i pasurisë ishte huaja nga prindërit, subjekti ka kryer deklaratim të pavërtetë në deklaratën e pasurisë *vetting*. Duke pasur parasysh periudhën e shkurtër kohore nga hartimi i deklaratës periodike për vitin 2015 – mars 2016 – dhe deklaratës *vetting* – janar 2017 – harresa apo gabimet e kujtesës për shkak të kohës përjashtohen si shkak i kësaj mospërputhjeje. Nga ana tjetër, subjekti ka deklaruar huanë nga prindërit në deklaratën periodike për vitin 2015, meqenëse në atë moment kohor kredia nuk ishte marrë ende, ndërsa kreditë në deklaratën e pasurisë *vetting*, meqenëse kjo e fundit ishte marrë në atë moment. Me fjalë të tjera, deklaratimet e subjektit nuk janë në funksion të pasqyimit të realitetit, por thjesht në funksion të nevojës për të rregulluar situatën e momentit.

12. Pasuria tjetër e krijuar me hua nga prindërit e subjektit, është një automjet [“Ford Kuga”], i blerë më 26 shkurt 2010, në vlerën 23.900 euro. Edhe për këtë pasuri, nuk ka burim të specifikuar në deklaratën e pasurisë *vetting*. Komisioni e ka konstatuar edhe këtë mungesë si deklaram të pasaktë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe ka analizuar deklaratën periodike vjetore për vitin 2010 për burimet e deklaruara të krijimit të pasurisë. Në konkluzion të analizës financiare të subjektit dhe personit të lidhur, si dhe asaj të kryer për mundësinë e prindërve për të dhënë hua në janar 2010 shumë përkatëse, Komisioni ka konstatuar mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e pasurisë, parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Në këtë konkluzion, Komisioni ka mbajtur parasysh faktin që në periudhën e ndërmjetme kohore, nga viti 2003 deri më 31 dhjetor 2010, prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë kryer shpenzime të konsiderueshme nëse përllogariten pasuritë e krijuara²⁴ dhe huaja e dhënë subjektit.
13. Edhe në analizën e kryer në Kolegj, duke mos përllogaritur investimet e kryera nga prindërit në periudhën kohore në analizë, rezultoi një balancë negative, duke përllogaritur vetëm shpenzimet e jetesës. Në vijim të arsyetimit tim të mësipërm për mungesën e besueshmërisë së pretendimeve të subjektit për përdorim të të ardhurave të prindërve për të dyja pasuritë, edhe për këtë aspekt e gjej pretendimin e subjektit me mungesë besueshmërie. Duke mbajtur në konsideratë fakte të pakontestueshme, si detyrimet e prindërve për dy fëmijë të tjerë, dhe të ardhura modeste të tyre krahasuar me subjektin dhe personin e lidhur, përfshirë edhe të ardhurat e këtyre të fundit nga qiraja e një apartamenti të analizuar në vijim, sikurse edhe faktin e mungesës së gjurmëve për dhënien e shlyerjen e huasë, vlerësova se në analizën tërësore të kryer për kriterin e pasurisë për subjektin, balanca negative prej thujse (-) 1,2 milionë lekësh që përftohet duke përllogaritur vetëm shpenzime jetese kundrejt të ardhurave të dokumentuara të prindërve, parë si pjesë integrale e sa është shtjelluar më sipër për huanë për apartamentin, përjashtojnë mundësinë e zbatimit të parimit të proporcionalitetit. Edhe parë veçmas nga problematika e pasurisë tjetër, analizuar në vijim, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, nuk rezulton e besueshme në kriterin e vlerësimit pasuror.

B. Pasuria e krijuar me “cedim kontrate”

14. Subjekti dhe personi i lidhur kanë në pronësi një apartament në qendër të Tiranës, me sipërfaqe 90 m², regjistruar në vitin 2015. Kjo pasuri është analizuar në Komision në funksion të të ardhurave që ka gjeneruar nga qiratë, në shumë prej 19.454 eurosh. Këto të ardhura janë deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit si burime financiare për krijimin e apartamentit të sipëranalizuar. Pasi ka vlerësuar mënyrën e krijimit të kësaj pasurie, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave nga qiraja, pasi nuk provohet fitimi i të drejtave të pronësisë nga personi i lidhur. Në këtë vlerësim, fokus kryesor për Komisionin ka pasur një konstatim sipas të cilit ceduesit e pronës nuk kanë pasur të drejta pronësie, por vetëm përdorimi mbi truallin ku është ngritur pallati, pjesë e të cilit është edhe apartamenti në emër të personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit.

²⁴ Paragrafi 20.28 i vendimit të Komisionit.

15. Ndaj qëndrim të ndryshëm me Komisionin pjesërisht, dhe me shumicën e trupit gjykues të Kolegjit në tërësi për sa i përket krijimit të kësaj pasurie dhe, për pasojë, të përlllogaritjes së të ardhurave nga qiratë në burimet e krijimit të apartamentit. Konkretisht, ndërsa jam dakord me Komisionin që mënyra e krijimit të kësaj pasurie ka probleme të ligjshmërisë, e shoh problematikën në një perspektivë dhe me një arsyetim të ndryshëm. Vlerësimi im është në linjë me jurisprudencën e Kolegjit deri më sot, në dy çështje në të cilat subjektet e rivlerësimit kanë pretenduar krijim pasurie të paluajtshme si pagesë në natyrë të përfaqësimit ligjor/shërbimeve të konsulencës juridike. Në të dyja ato çështje²⁵, Kolegji ka konstatuar që në mungesë të dokumentacionit mbështetës që provon pikësëpari ekzistencën e marrëdhënies konkrete dhe faturimin e shërbimit për këtë qëllim, sikurse edhe pagesën e detyrimeve tatimore për qëllim të gjurmueshmërisë dhe ligjshmërisë së të ardhurave, pretendimet për pagesë në natyrë – nëpërmjet një pasurie të paluajtshme, në rastin konkret – nuk kapërcejnë pragun e kërkuar nga Aneksi i Kushtetutës dhe ligji.
16. Në rrethanat faktike konkrete, apartamenti deklarohet të jetë krijuar nëpërmjet “cedimit të kontratës” në vitin 2012, konfirmuar nga palët sërish në vitin 2015. Në deklaratën e datës 17.12.2012, trashëgimtarët e një familjeje që ishte palë në një konflikt civil lidhur me truallin dhe pallatin e ndërtuar mbi të [ku ndodhet pasuria objekt analize], deklarojnë me efekt prapaveprues t’i kalojnë personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit një apartament në pallatin e ndërtuar në kryqëzimin mes rrugës “{****}” dhe “{****}” në Tiranë, sipas një kontrate sipërmarrjeje të vitit 1997. Në të njëjtën deklaratë, palët “konfirmojnë” me efekt prapaveprues edhe të ardhurat nga qiratë e fituara nga personi i lidhur.
17. Ndaj vlerësim të ndryshëm nga shumica e trupit gjykues pasi nga analiza e akteve dhe shpjegimeve të subjektit, konstatoj që shërbimet juridike me peshë dhe të shtrira në kohë, si pasojë e të cilave është fituar prona, i përkasin vetë *bashkëshortit* të subjektit. Për pasojë, edhe detyrimet për të provuar vlerën financiare të faturuar të shërbimeve dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore për to në funksion të provueshmërisë e ligjshmërisë, i përkasin personit të lidhur/bashkëshortit dhe vetë subjektit. Në fillosat e veta, provohet marrëdhënie shërbimi e ofruar edhe nga vjehri i subjektit, por marrëdhënia juridike dhe shërbimet ligjore të cilat kanë sjellë frytet e kërkuara për “ceduesit” dhe kurorëzuar me fitimin e kontestit civil, janë ato të krijuara me bashkëshortin e subjektit. Ky i fundit rezulton të ketë përfaqësuar familjen në kontest civil në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe atë të Apelit në Tiranë, në të paktën dy procedime të gjykuara në vitet 2007 dhe 2013, ndërkohë që i ati ka ndërruar jetë në gusht 2006²⁶. Mbi të gjitha, nga aktet, vjehri duket të ketë qenë përfaqësuesi ligjor në një gjykim në shkallë të parë, shpallur më 05.04.2005, në të cilin pala e përfaqësuar prej tij ka qenë gjyqumbëse. Në një analizë të thjeshtë, në kushtet që konflikti civil dokumentohet të ketë qenë aktiv për të paktën shtatë (7) vite pasi vjehri ka ndërruar jetë, dhe kurorëzuar me sukses për palën e përfaqësuar vetëm në një kohë dhe pas angazhimit nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit si avokat, është e logjikshme të deduktohet që shërbimet e ofruara nga ky i fundit kanë

²⁵ *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit E. Imeraj (JR 11/2022) dhe në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit A. Balliu (JR) 32/2022.*

²⁶ *Sipas shpjegimeve të subjektit në rezultatet e hetimit administrativ.*

qenë substanciale e me peshë vendimtare. Nga ana tjetër, deklarimi për “cedim” i vitit 2012, referon një kontratë sipërmarrjeje mes ceduesve dhe një shoqërie ndërtimi tjetër²⁷, e cila është zëvendësuar në të drejtat dhe detyrimet e saj, pa specifikuar kohën kur shërbimet juridike të vjehrrit kanë nisur apo të përcjellë provë të një marrëveshjeje mes tyre dhe vjehrrit të subjektit për shpërblim në natyrë.

18. Me fjalë të tjera, marrëdhënia dhe veprimet ndër vite dëshmojnë për shërbime të kryera nga bashkëshorti, të shtrira në kohë dhe me rezultate pozitive që duket se përkrijnë edhe me nevojën dhe dinamikën e konfliktit civil mes palëve. Për këto shërbime të kryera nga bashkëshorti i subjektit, nuk ka faturime konsulence. Situata do të ishte ndryshe nëse përpos deklarimeve të palëve në prani të një shoqërie ndërtimi për të dakordësuar shpërblimin në natyrë në favor të bashkëshortit të subjektit – që rezulton nga dokumentacioni në fashikull – do të ekzistonin fatura për shërbimet e kryera prej tij në periudhën pasi i ati ndërroi jetë. Në atë rast, fillesa dhe pesha e marrëdhënies së krijuar mes ceduesve dhe babait të bashkëshortit të subjektit do të paraqitej e qartë dhe vijimësia e marrëdhënies e konfirmuar.
19. Në mungesë të aspekteve që provojnë se apartamenti përbën kundërvlerën e shërbimit të kryer tërësisht/në pjesën vendimtare nga vjehrrit i subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Hicka, e për pasojë do të shkarkohej ajo dhe personi i lidhur nga shlyerja e detyrimeve për ligjshmërinë, vlerësova se të ardhurat nga qiraja e kësaj pasurie nuk përmbushin kriteret e ligjshmërinë sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Akti noterial i vitit 2012 që paraqitet si akt me fuqi prapavepruese, jo vetëm që nuk jep të dhëna për arsyet për të cilat është hartuar në një moment kohor që përkon me tre (3) vjet pasi personi i lidhur gëzonte të drejta reale nga kjo pasuri, por mbi të gjitha dështon të konfirmojë që lidhja dhe marrëdhënia e detyrimit të ceduesve është ajo që pretendon subjekti, e konkretisht me vjehrrin, dhe jo me bashkëshortin e saj. Deklarata përbën në thelb një dakordësi në prani të një ndërtuesi, i cili merr përsipër të njohë një përfitues shtesë, përpos atyre të përcaktuar më herët nga palët²⁸.
20. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit rezulton me pasaktësi në deklaram dhe mungesë burimesh për krijimin e pasurive të sipëranalizuara, që janë në vlera të cilat nuk justifikojnë zbatimin e parimit të proporcionalitetit. Në analizën e kryer në Kolegj mbi bazën e akteve të hartuara gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Hicka, rezultoi me një mungesë burimesh prej mbi 4 milionë lekësh për krijimin e pasurive me të ardhurat e saj dhe të personit të lidhur. Personat e tjerë të lidhur, prindërit, nuk kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për të dhënë huatë prej 5 milionë lekësh në vitin 2015 dhe 1,8 milionë lekësh në vitin 2010, për diferencat në vlerat 2,1 milionë lekë dhe 1,2 milionë lekë, përkatësisht.

²⁷ Kontratë sipërmarrjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.10.1997, mes “{***}” ShPK dhe familjes A..

²⁸ Deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.7.2015, sipas së cilës palët parashikojnë që: “[...] Trashëgimtarët e Ll. A. [...] me vullnetin e tyre të lirë deklaruan: [...] kemi marrë në dorëzim nga shoqëria “{***}” ShPK, pasuritë e ndara respektivisht ndërmjet nesh [...] nga këto pasuri i kemi dorëzuar z. E. H. apartamentin e treguar më poshtë [...]”.

21. Për gjithë sa më sipër, çmova që vendimi i Komisionit që shkarkoi nga detyra subjektin e rivlerësimit, duhet të lihej në fuqi.

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi